

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7829 E shtunë 23 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Nga XHEVAT MUSTAFA

"Qeverinë që duam apo nuk duam" e rrezojnë vetëm ...socialistët

Këto dy vitet e fundit partitë opozitare kanë organizuar rrallë e për mall disa protesta masive. Si në shumicën e protestave në botën demokratike, siç po ndodh e po ...

Vijon në faqet 20-21

Opinion *i* **Ditës**

Nga FATOS ÇOÇOLI

Juntë brenda nesh?

Fjalë "Juntë" vjen nga spanjishtja dhe ka prejardhje edhe më të lashtë, latinishten, me foljen "jungere (shqipto: junxhere)", që do të thotë me bashku. Ka ...

Vijon në faqet 21



Plumba Ravik Gurrës në mes të qytetit

Atentati në Elbasan, ekzekutohet me armë avokati i Çapjave dhe i Emiljano Shullazit

50-vjeçari vritet me silenciator, autorët e krimin i vënë flakën makinës së vjedhur

Tronditet Elbasani. Një 50-vjeçar është ekzekutuar me plumb pas koke në qendër të këtij qyteti. Bëhet fjalë për avokatin e njohur Ravik Gurra, i cili ka mbrojtur çështje të bujshme si ajo e Shullazit dhe Çapjave. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në një lokal të njohur në këtë qytet, ndërsa dyshohet se autori ka qenë i maskuar. Burime policore bënë me dije se ...

Në faqen 6

PROJEKTLIGJI/ LIROHEN GRATE MBI 55 VJEÇE DHE BURRAT MBI 60 VJEÇ

RIKTHEHET AMNISTIA, 350 TE BURGOSURIT QE PERFITOJNE

Ministria e Drejtësisë: Nisma u shty nga viti i kaluar, do ta votojmë me opozitën e re. Përfitojnë autorët e veprave penale që dënohen deri në 3 vjet burg



(Në foto) Një i burgosur (foto ilustruese)

Në faqen 5

DETAJET E MARATONES

Sot kongresi i PS, Rama: Jam mirë. PD: Administrata sillet në Tiranë me terror

Në faqen 3

TESTIMI I AFTESISE

Lista e plotë me 1200 kandidatët për provimin e Infermierisë

Në faqen 8-9

"BLUETOOTH"

Sabri Fejzullahu dhe Flori Mumajesi, plas sherri për klikimet në Youtube

Suplement

HUMBJA 0 - 2

Turqia "fundos" Shqipërinë, tifozët kërkojnë "kokën" e Panuçit

Në faqen 22

"REFLEKTIM PER VLERAT"



Meta uron festën e Sulltan Novruzit: Pranverë në zemrën e çdo shqiptari

Në faqen 4

Lista e tretë/ 600 familjet që fitojnë të drejtën mbi truallin e ndërtimit

Pronarët që marrin tapitë në Tiranë e në rrethe

Vendimi i qeverisë/ Emrat edhe në Durrës, Elbasan, Shkodër e Korçë

Miratohet lista me personat që kanë ndërtuar pa leje dhe fitojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqet ndërtimore. Me një vendim të veçantë, qeveria ka përcaktuar metra katrorë për parcelat ndërtimore në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan



dhe Korçë. Janë 600 përfitues në të gjithë vendin, të cilët do të marrin tapitë për truallin mbi të cilin kanë ndërtuar. Në listën e miratuar nga qeveria janë përcaktuar sipërfaqet për çdo përfitues, ndërsa ngarkohet ALUIZINI për pasqyrimin e tyre ...

Në faqet 10-11

KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Gjermania: Garantoni votën, të gjitha partitë të garojnë në zgjedhjet e 30 qershorit

Valentina Madani

Qeveria gjermane e quan të gabuar djegien e mandateve parlamentare në bllok nga deputetët e opozitës, por njëherësh apelojnë për garantimin e votës së lirë dhe pjesëmarrjen e të gjitha partive politike në zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Zyrtarët e qeverisë gjermane, Christian Hellbach dhe Thomas Ossoeski, në përfundim të vizitës së tyre në Tiranë, u bënë dje thirrje të gjitha partive të tregojnë përgjegjësi përkundërt zgjedhësve të tyre dhe të marrin pjesë në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor. Zyrtarët gjermanë takuan Presidentin Meta, kryeministrin Rama, ministrin e Brendshëm Lleshaj, ministrin në detyrë të Punëve të Jashtme Cakaj si dhe kreun e PD-së, Lulzim Basha dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Tema e bisedave ishte situata aktuale e politikës së brendshme pas dorëzimit të mandateve nga opozita. "U bëjmë thirrje të gjitha partive të tregojnë përgjegjësi përkundërt zgjedhësve të tyre dhe të marrin pjesë në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor. Rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, të cilat u drejtohen si pushtetit ekzekutiv, ashtu edhe atij legjislativ kanë bërë të qartë se në cilët sektorë duhet të përmirësohet ende sistemi zgjedhor shqiptar. Qeveria Federale është angazhuar prej muajsh tanimë, që reforma zgjedhore të shkojë përpara dhe ka financuar ndër të tjera punën e ekspertëve të pavarur për këtë qëllim", deklaruan zyrtarët gjermanë. Në një deklaratë të publikuar nga ambasada gjermane në Tiranë, ata shprehën se, "e drejta për të protestuar është një element i rëndësishëm i kushtetutshmërisë demokratike, por dhuna është e papranueshme". Për ta, Shqipëria është në rrugë të mbarë psh., në reformën e drejtësisë, kurse bojkoti i parlamentit dhe sidomos dorëzimi i mandateve është për i gabuar. Zyrtarët gjermanë thanë se Shqipëria duhet të zhvillojë instrumente efektive për të parandaluar mashtrimet në zgjedhje dhe blerjen e votave, si dhe për të ndjekur në mënyrë të vendosur çdo moment dyshimi. "Duhet të garantohet besimi i pakufizuar i qytetarëve në forcën e votës së tyre, por kjo arrihet vetëm me një parlament funksional. Ne u bëjmë thirrje të gjitha partive të punojnë në mënyrë konstruktive për reformën zgjedhore. Akuzat, të cilat kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e zgjedhjeve të kaluara duhet të verifikohen dhe përpunohen nga drejtësia dhe parlamenti, në përputhje me procedurën e parashikuar për këtë", deklaruan zyrtarët gjermanë pas vizitës në Tiranë.

Basha: Shqipëria na thërret, rruga drejt Europës në udhëkryq

Zyrtarët gjermanë: Pro protestave, zgjidhja në Kuvend



Zyrtarët e qeverisë gjermane Christian Hellbach dhe Thomas Ossoeski

DEKLARATA

"Duhet të garantohet besimi i pakufizuar i qytetarëve në forcën e votës së tyre, por kjo arrihet vetëm me një parlament funksional. Ne u bëjmë thirrje të gjitha partive të punojnë në mënyrë konstruktive për reformën zgjedhore. Akuzat, të cilat kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e zgjedhjeve të kaluara duhet të verifikohen dhe përpunohen nga drejtësia dhe parlamenti, në përputhje me procedurën e parashikuar për këtë", deklaruan zyrtarët gjermanë pas vizitës në Tiranë.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha gjatë protestës së opozitës para parlamentit

"Mandatet", Kryemadhi: Mundësia e vetme për të kthyer vendin në shtratin kushtetues

Për kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi, djegia e mandateve nga opozita ishte mundësia e vetme për të kthyer vendin në shatin kushtetues. Pas thirrjeve të Kryegjyshit Botëror i Bektashinjve, Haxhi Edmond Brahimaj për dialog politik, kryetarja e LSI në një deklaratë për gazetarët tha se djegia e mandateve është dashuria e opozitës për kombin. "Dashuria për kombin është djegia e mandateve që bëri opozita, sepse ajo tregoi ndarjen përfundimtare të çdo pazari dhe djegia e mandat-



nat dhe shtratin kushtetues. Për sa i përket bektashizmit, Abaz Aliu u vra nga Jezidi dhe Mavija, në betejën e Qerbelasë. Kështu që gjithmonë beteja të tilla janë beteja që kanë kosto, por në fund të fundit kanë një vlerë për të sjellë, sikur Abaz Aliu solli demokracinë njerëzore, por duhet të sjellim sot jetën dhe mirësinë për shqiptarët", tha zj. Kryemadhi. Ajo përcollti edhe një mesazh për kryebashkiakun e Tiranës: "I uroju sukses Eri- on Velajt sot në ditë Nevruzit, nesër flasim për Erionin dhe çfarë ka mbrapa Erionit".

dhe përpunohen nga drejtësia dhe parlamenti në përputhje me procedurën e parashikuar për këtë", thuhet në deklaratën e përbashkët.

TAKIMET

Lideri i opozitës, Lulzim Basha, i sapokthyer nga Brukseli në takime intensive me zyrtarët të lartë evropianë, paraditën e djeshme e kaloi në takime me përfaqësues ndërkombëtarë në vendin tonë. Rreth orës 10:00 në zyrën

e Bashës shkoi ambasadori britanik, Duncan Norman, ku në qendër të bisedës ishte situata politike e krijuar pas djegies së mandateve dhe protestave të vazhdueshme të opozitës. Pas largimit të ambasadorit britanik, në zyrën e Bashës mbërriti ambasadorja gjermane, Susanne Schutz, e shoqëruar nga Christian Hellbach, drejtor për Europën Juglindore. Takimi zgjati rreth 60 minuta, ndërsa

Basha i shmangu komentet për mediat. Kreu i opozitës vetëm disa minuta më vonë lëshoi një mesazh politik nga oborri i Kryegjyshit Botërorë të Bektashinjve. Sipas tij, ditë me të mira do të vijin për të arritur vlerat, për të cilat luftuan martirët e kësaj feje dhe shqiptarët, që në 22 mars, 27 vjet më parë votuan për herë të parë pro demokracisë. Por, Basha shprehu bindjen se besimi për

"Sëmundja e diktatorëve", Bardhi: Dosja 339 dhe 184, halli më i madh i Ramës

Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi, deklaroi dje se halli i Edi Ramës nuk janë negociatat me Bashkimin Evropian, por dosja 339 dhe 184, ku zyrtarët e tij socialistë janë kapur duke blerë vota për llogari të tij. Rama sipas Bardhit i gënjeu shqiptarët se gjoja 4 ditë u zhduk nga Shqipëria për të biseduar me ndërkombëtarët, por askush nuk e di se çfarë bëri kryeministri në Paris dhe Berlin dhe me kë u takua fshehurazi. "Halli i Edi Ramës nuk janë negociatat. Halli i vetëm i tij është ruajtja me çdo çmim e karriges së kryeministrit, të cilën ia ka blerë krimi i organizuar. Është ky hall që e detyroi të fshihej 4 ditë me radhë, pa e ditur askush çfarë bëri kryeministri i vendit në Paris dhe Berlin, me kë dhe përse u takua fshehurazi. Dosja 339, dosja 184 dhe ndonjë dosje tjetër janë halli më i madh i Edi Ramës. Ato i faktojnë para botës se ai vuan nga sëmundja e diktatorëve - mbajtjen e pushtetit me çdo çmim, duke bërë pakt me krimin dhe duke blerë vota me paratë nga trafiku ndërkombëtar i drogës. I sëmurë i Ballkanit është halli më i madh që kanë shqiptarët. Është ky hall që mban dyert e Europës mbyllur, që i varfëron çdo ditë shqiptarët për të pasuruar veten dhe një grusht oligarkësh. Këto 6 vjet na kanë treguar se pa zgjidhur këtë hall, për shqiptarët nuk do të ketë Europë, nuk do të ketë mirëqenie. Protestoj! Shqipëria si Europa", tha z. Bardhi.



një të nesërme më të mirë do të na bëjë bashkë. Më herët z. Basha deklaroi se rruga e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian është në udhëkryq. "Më 22 mars 1992 shqiptarët fituan lirinë. Si sot 27 vjet më parë njerëzit u bashkuuan me të vetmen dëshirë dhe ëndërr: lirinë për të ndërtuar një jetë më të mirë, lirinë për të lëvizur, lirinë për arsim, lirinë për biznes, lirinë për t'u shprehur, lirinë për të zgjedhur e për t'u

zgjedhur. Ky udhëtim 27-vjeçar drejt lirisë dhe Europës demokratike me arritet dhe deshtimet e tij ka qenë i dhimbshëm dhe plot sakrificë. Sot Shqipëria po na thërret përsëri, sepse rruga jonë drejt lirisë dhe Europës është në udhëkryq! Është në dorën tonë ta përmbyllim atë duke ndërtuar edhe në Shqipëri sistemin e vlerave të vërteta evropiane", shprehet z. Basha.



Sesioni i dytë i kongresit do mbahet në shesh ku janë vendosur 10 mijë karrige

PS mbledh kongresin elektoral, prezantohet Veliaj dhe këshilltarët

PS ka marrë masa për një pjesëmarrje të madhe në shesh

Socialistët mbledhin sot në kongresin e tyre elektoral me moton "Bashkitë që duam për Shqipërinë që duam". Për këtë qëllim dhe në mbërmje ishte thuar se çdo gjë gati, si në Pallatin e Kongreseve ashtu edhe në sheshin "Nënë Tereza" ku dhe do të mbahen dy sesionet e para të këtij kongresi. Sipas axhendës së publikuar tashmë nga Partia Socialiste kongresi është konceptuar për t'u zhvilluar si i ndarë në tre sesione dhe për këtë arsye ai do të mbahet në 3 ambiente të ndryshme.

SESIONI I PARË

Në Pallatin e Kongrese do të bëhet celja e Kongresit nga sekretari i përgjithshëm, Taulant Balla dhe do të zhvillohet sesioni i Bashkëqeverisjes me njerëzit. Kështu pas Taulant Ballës fjalën do e marrë zëvendëskryeministri, Erion Braçe, i cili do flasë mbi rezultatet e qeverisjes sidomos në aspektin e ofrimit të shërbimeve, ndërkohë që pas tij fjalën do e marrë ministria e Drejtësisë Etilda Gjonaj, e cila do të flasë mbi rezultatet e luftës kundër korrupsionit dhe zbatimit të reformave. Ndërkohë që në skenën do të hipin edhe dëshmitarët të shumtë që do flasin për rastet e suksesi të bashkëqeverisjes me njerëzit. Më pas kongresi do t'i kushtohet punës së qeverisë "Për bashkitë që duam". Për të folur për këtë janë parashikuar që të flasin me radhë disa ministra. Më pas në formën edhe të një prezantimi si kandidat për kryetar bashkie do të ftohen të flasin disa kryetarë bashkie aktual të cilët konsiderohen si modele suksesi të qeverisjes vendore dhe dy nga kandidatët e rinj të PS-së për kryetar bashkie. Më konkretisht janë parashikuar të flasin Armando Subashi, Sotirajq Filo, Dritan Leli dhe Majlinda Bufi. Të katër këta si kryebashkiak që rikonfirmohen për një mandat të dytë. Po ashtu "Për bashkitë që duam" do të flasin edhe deputeti Pjerin Ndreu dhe kreu i prefekti i Qarkut Elbasan, Gledian Llatja. Shqipëria në Bashkimin Europian: Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme Gent Caka Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin Elisa Spiropali



SESIONI I TRETË

Ndërkohë që pas një pushimi të shkurtër do të nisë edhe sesioni i tretë, i cili do jetë ndarë në tre panele. Dy panele do ta zhvillojnë punimet në Pallatin e Kongreseve dhe njëri në një prej hoteleve në afërsi të sheshit "Nënë Tereza".

PREZANTIMI

PS ka ftuar qytetarët e Tiranës të bëhen pjesë e këtij takimi, ndërsa në shesh janë vendosur nëpërmjet një plani të mirëorganizuar mbi 10 mijë karrige. Ndërkohë që pjesëmarrja parashikohet të jetë më e madhe dhe qytetarët do qëndrojnë edhe në bulevard deri afër kryeministrisë. Takimi në shesh do të hapet nga kryetarja e PS-së së Tiranës, Blerina Gjylameti dhe më pas do të flas kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

Rama: Ata që shpifën për sëmundjen time do përgjigjen në gjyq

Kryeministri Edi Rama Kduke uruar festën e 'Sulltan Novruzit' ftoi dje qytetarët që të marrin pjesë gjatë ditës së sotme në takimin "Bashkia që duam" në sheshin "Nënë Tereza", mbledhje kjo që sipas tij do të shërbejë si një nisë fushatës për zgjedhjet lokale të 30 qershorit. "Ju ftoj të vini në orën 12:00 në sheshin Nënë Tereza, për ciklin bashkia që duam për Tiranën. Nesër (sot) është dita e ndezjes së motorëve elektoralë për të gjitha bashkitë" - tha Rama përmes rubrikës "Përgjigjia ime" në 'Facebook'. Ai komentoi edhe lajmin e publikuar për gjendjen e tij shëndetësore, ndërsa tha se vizita e tij në Francë dhe Berlin ka qenë për hallin e Shqipërisë dhe jo për shëndetin e tij. "Sikur e shihni jam mirë, nuk jam në spital në Berlin, por zyrë në Tiranë. Njerëz jemi edhe mund të



sëmuremi, por ky nuk ishte rasti im këto ditë. Në Berlin isha për hall, por jo për shëndetin tim, por për t'u shpjeguar partnerëve dhe miqve arsyet e pamjeve të shëmtuara të kundërshtarëve që eksportojnë nëpër botë nga protestat e tyre dhe për t'u kërkuar mbështetje për çeljen e negociatave dhe për të kuptuar më shumë për situatën politike të brendshme në vendet kyçe për negociatat mbi vendimarrjen. Ishte vizitë jo zyr-

tare, me ish-presidentë, ish-kryeministra dhe bisedat në Bundestag me përfaqësues të ndëruar të partisë kryesore të koalicionit qeverisës" - tha ai. Kryeministri Edi Rama shtoi se do padisë në gjykatë ata që sajan për sëmundjen e tij. "Patqeqësisht shumë miq këtu në Shqipëri dhe jashtë, që qeshën me këtë historinë e sëmundjes. Ataku në zemër sajese e kazanit të opozitës tonë rrugë humbur, kjo do të thotë të prekësh fundin. Me keqardhjen për shqetësimin që është krijuar, nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'i mëshiroj. Do u kërkoj që të përgjigjen në gjyq dhe të paguajnë për sajesën. Se unë qenkam shtruar në Gjermani në spitalin me emrin Mustafa Rama, me një emër fals dhe me mbiemrin tim, për të qeshur për mua dhe për të qarë për ju", u shpreh Rama.

PROGRAMI I KONGRESIT

10.00 - Hapja e Kongresit. Seanca e parë.

- Fjala hyrëse nga Sekretari i Përgjithshëm i PS Taulant Balla.
- Bashkëqeverisja me njerëzit:
- Zëvendës Kryeministri Erion Braçe
- Ministri Drejtësisë Etilda Gjonaj
- Dëshmitarë të shumë rasteve suksesi të bashkëqeverisjes me njerëzit
- Puna e qeverisë për bashkitë që duam. Prezantime sektoriale:
- Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Bledi Çuçi
- Ministri i Energjisë dhe Infrastrukturas Belinda Balluku
- Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu
- Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë Besa Shahini
- Ministri i Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi
- Ministri i Kulturës Elva Margariti
- Bashkitë që duam:
- Kryetari i Bashkisë Fier, Armando Subashi,
- Kryetari i Bashkisë Korçë, Sotirajq Filo,
- Deputeti i Lezhës, Pjerin Ndreu,
- Kryetari i Bashkisë Vlorë, Dritan Leli
- Kryetari i Bashkisë Roskovec, Majlinda Bufi
- Prefekti i Qarkut Elbasan, Gledian Llatja
- Shqipëria në Bashkimin Europian:
- Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme Gent Caka
- Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin Elisa Spiropali

Miratimi i Deklaratës së Kongresit

12.00 - SEANCA E DYTË

"BASHKIA QË DUAM" - Tirana

- Fjala hyrëse nga Kryetarja e PS Tiranë Blerina Gjylameti.
- Kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj dhe prezantimi i listës së kandidatëve të PS për anëtarë të Këshillit Bashkiak Tirane
- Fjala e Kryeministrit të Shqipërisë, Kryetarit të PSSH EDI RAMA

15.00 - SEANCA E TRETË E NDARË NË TRI PANELE.

- Bashkitë që duam për Shqipërinë që duam - Pallati i Kongreseve
- Edukim cilësor dhe punësim për të rinjtë - Pallati i Kongreseve
- Reforma zgjedhore dhe vota e emigrantëve - hotel "Sheraton"

PRESIDENTI MESAZHI

Festa, Veliaj: Në mandatin e ri do hapim më shumë qendra dhe mensa sociale

Valentina Madani

Presidenti i vendit Ilir Meta apeloj dje për më tepër reflektim me qëllim ringjalljen e vlerave më të mira kombëtare. Në Pogracec 3 ditë më parë solli si shembull të vetësakrifikimit për të triumfuar mbi anarkinë dhe sjellë demokracinë një figurë të njohur ndërkom-bëtarisht, presidentin e vetëvrasës kilian Salvador Allende rrugën e të cilit, tha se ishte gati ta ndiqte. Këtë ditë feste të Sulltan Novruzit Presidenti i Republikës i referohet një tjetër figure, po kësaj të njohur vetëm në vend, e që i përket fesë bektashiane e që thotë se u sakrifikua për demokracinë. "Kjo është dita e ringjalljes që na fton të reflektojmë më shumë për të ringjalluar vlerat më të mira kombëtare në emër të atyre idealeve për të cilat sakrifikoi Imam Aliu për të idealizuar jetën e për të zhvilluar demokracinë, pranverë për të gjithë", deklaroi z.Meta. Me rastin e Festës së Sulltan Novruzit, Presidenti i Republikës, Ilir Meta vizitoi dje Selinë e shenjtë të Kryegjy-shatës Botërore Bektashiane, ku u prit nga Kryegjyshi Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj dhe klerikë të tjerë bektashianë. Presidenti i Republikës u uroi të gjithë besimtarëve bektashianj "Gëzuar Festën e Sulltan Novruzit", shëndet e mbarësi për ta dhe familjet e tyre si dhe për të gjithë shqiptarët, kudo ndodhen. "Në këtë ditë feste dhe optimizmi pranveror, që simbolizon lindjen e shpresës, rigjallërimin e natyrës dhe përkoren me lindjen e Imam Aliut, dua t'i uroj mbarë popullit shqiptar dhe në veçanti besimtarëve bektashianë kudo ndodhen: Gëzuar Festën e Sulltan Novruzit! Shëndet dhe mbarësi paçi gjithmonë në familjet tuaja! Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe kombin shqiptar!", deklaroi kreu i shtetit.

DEKLARATA

Bashkia e Tiranës zgjodhi dje që festën e Sulltan Novruzit të komunitetit bektashi ta kalojë pranë të moshuarve, njerëzve në nevojë dhe atyre me aftësi të kufizuara. Ashtu siç është tashmë traditë, edhe në këtë festë të rëndësishme për komunitetin bektashi, Bashkia e Tiranës shtroi një drekë festive për të gjithë personat që frekuentojnë mensat sociale të kryeqytetit. Festës iu bashkua edhe kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i cili i shoqëruar nga Valbona Selimllari, shërbeu drekën në mensën e re sociale "Gonxe Bojaxhi", e hapur në Njësine 4. Ai uroi gjithë besimtarët bektashianj për festën dhe theksoi se ditë të tilla janë një mundësi e mirë për të qenë pranë atyre që kanë

Sulltan Novruzit, Meta: Reflektim për rigjallërimin e vlerave tona

"Për idealet që sakrifikoi Imam Aliu"



Presidenti Ilir Meta, dhe Kryegjyshi Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj

APELI

"Kjo është dita e ringjalljes që na fton të reflektojmë më shumë për të ringjalluar vlerat më të mira kombëtare në emër të atyre idealeve për të cilat sakrifikoi Imam Aliu për të idealizuar jetën e për të zhvilluar demokracinë, pranverë për të gjithë", deklaroi z.Meta.



Presidenti Ilir Meta, dje në Kryegjyshatën Botërore të Bektashizmit

Akuza, Salianji publikon përgjimet e dosjes

'Babalja', PD: Shefi i policisë së Fierit foli me Alizotin, i premtoi dhënien e lekëve

PD-ja publikoi dje një përgjim në të cilin sipas saj është ish-drejtori i Policisë së Fierit Albert Nushi dhe Fredi Alizoti, i cili sipas prokurorisë është personi që ka bërë zërin e Agron Xhafajt në dosjen "Babale". Ky material, sipas ish-deputetit Ervin Salianji ndodhet në dosjen e prokurorisë, e cila hetoi këtë çështje. Ervin Salianji i akuzuar për "kallëzim të rremë" dhe i marrë i pandehur për dosjen "Xhafaj-Babale" publikoi bisedën mes drejtorit të Policisë së Fierit dhe atij që ai e quan "dëshmitar të fabrikuar të qeverisë", Fredi Alizoti. Sipas Salianjit, në audiopërgjim, kuptohet fare mirë lidhja mes tyre dhe se si drejtori flet troç se po i dërgon njerëz me para me vete, sipas urdhrat që i



jep në telefon Fredi Alizoti. "Në pafundësinë e komunikimeve mes zyrtarëve të policisë dhe dëshmitarit të sajuar për Xhafajgate! Komunikimi në 00:30 të natës mes drejtorit të policisë Fier dhe Alizotit pasi ka dhënë dëshminë e sajuar! Përgjimi është zyrtar i prokurorisë, komunikim +18", shprehet z.Salianji. Pak ditë më parë prokuroria mbylli hetimet

për dosjen "Babale" duke dërguar në gjyq për kallëzim të rremë ish-deputetin Salianji, gazetarin Jetmir Oldashi, Albert Veliu i njohur ndryshe si Babalja, dhe Fredi Alizotin. Këta persona, sipas prokurorisë, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë krijuar prova të rreme në mënyrë që të implikonin Agron Xhafajn në trafikun e një sasive kanabisi nga Vlora drejt Italisë. Fredi Alizoti pranoi para prokurorisë se ishte zëri i tij ai në audiopërgjimin e bërë publik nga PD në maj 2018. Por në një video tjetër të bërë publike nga Salianji, Fredi Alizoti pranonte se ishte shantazhuar dhe joshur me para nga drejtori i Policisë së Shtetit Ardë Veliu.

i mirë"-u shpreh Veliaj. Gjithashtu, kryetari i Bashkisë theksoi se edhe mensa sociale "Gonxe Bojaxhi" është kthyer një nga qendrat ku çdokush mund të gjejë mbështetje dhe një vakt të ngrohtë. "Më bëhet zemra mal sa herë vij të kjo qendër sociale, sepse takoj shumë prej jush, dhe më vjen mirë që vazhdon shërbimi e puna në komunitet", tha z.Veliaj.

PETRIT VASILI

Nënkryetari i LSI-së Petrit Vasili akuzoi dje se policia është e nënshtruar nga krimi, dhe se kryeministri Rama është i "sëmurë nga sëmundja e vërsisë nga kriminelet dhe nga kapja prej tyre".

PËRGJIMET, URDHRI I ALIZOTIT PËR SHEFIN E POLICISË SË FIERIT

■ Komunikimi në 00:30 të natës mes drejtorit të policisë Fier dhe Alizotit pasi ka dhënë dëshminë e sajuar!

BISEDA E TRANSKRIPTUAR

Numri është i telefonit të drejtorit të policisë së Fierit, Bert Nushi
Ora 12:28 e natës

Drejtori: Fredi,

Fredi: Ai është b.q prokuror, të më thotë ai mua...

Drejtori: Ku je, se nuk..

Fredi: Dëgjo mua, atë që kam nisur...eee

Drejtori: Ku je në Fier apo jo,

Fredi: Të kam q.. robt, atë që kam nisur nuk e kthej mbrapa, a ti thosha të kam q...motrën mu në p...

Drejtori: Fredi, po më dëgjo, Fredii

Fredi: Unë nuk di si më lini në rrugë mua, vari k muhabetë, i ka marrë në dorë Gramozit këto punë

Drejtori: Se jam në vendngjarje tani, ça do, më thuaj

Fredi: Do më dërgosh njeri që të flas

Drejtori: Jam në Fier kam një ngjarje, jam në Ballsh

Fredi: E mban mend ku me ke lënë herën e parë, më dërgo njeri për cerek ore,

Drejtori: Ka mundësi të mos më kapë telefoni se jam në vendngjarje

Fredi: E dëgjon, aty ku më le, e mban mend

Drejtori: Po do të nis unë njeri me lekë

Fredi: Po e kape, e do troç, e kap, jam në mes të rrugës.

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ankandin e tretë të pasurisë të palës debitorë Sh "ARNI" sh.p.k dhe hipotekuesve P Goxhaj dhe M Goxhaj, Pasuria që del në ankand të tretë përbëhet nga:
* Apartament , me Nr pasurie 63/11ND+1-14 ndodhur në Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati i 3 Ap 14, Orikum e regjistruar në ZVRPP- Vlore, Z.K Nr.2532, vëllimi 16, faqe 120.
Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 1.209.600 lekë
Ankandi do të zhvillohet në datë 10.04.2019 në orën 15:00 në selinë e Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt 067 2082543 e-mail ilir_dervishaj@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice.al.com.



Ministria Gjonaj ka konfirmuar dje se drafti do të miratohet me votat e opozitës së re

Amnistia për 350 të burgosur, në Kuvend, ja kategoritë që përfitojnë

Amnistohen gratë mbi 55 vjeçe dhe burrat mbi 60 vjeç

Më shumë se 350 të burgosur që vuajnë dënime të ndryshme në burgjet e Shqipërisë do të kenë mundësi që shumë shpejt të lënë qelitë dhe të rikthehen pranë familjeve të tyre. Ministria e Drejtësisë ka bërë gati draftin përfundimtar të amnistisë dhe shumë shpejt pritet ta dërgojë për miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Lajmin e ka dhënë dje vetë ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, e cila duke folur gjatë inspektimit të spitalit të burgjeve në Tiranë, bëri të ditur se për të lehtësuar mbipopullimin e burgjeve do të dërgohet në Kuvend projektligji për amnistinë. Sipas saj, tashmë që në Kuvend ka ardhur një opozitë e re dhe për shkak se miratimi i një projektligji të tillë kërkon shumicë të cilësuar votash, janë krijuar kushtet për ta miratuar këtë nismë. "Drafti për amnistinë është gati dhe do të ridërgohet në Kuvend. Për shkak të mungesës së opozitës dhe mungesës së vullnetit të tyre për të miratuar një amnistia, që miratohet me shumicë të cilësuar ka ngelur e pamiruar. Por tani që opozita, pjesa tjetër ka ardhur, do ta rishikojmë idenë sesi mund ta kalojmë sërish në parlament për miratim. Nga amnistia përfitojnë rreth 350 të dënuar", - u shpreh Gjonaj. Sipas projektligjit, do të përfitojnë nga amnistia të gjithë ata persona që nuk kanë kryer vepra të rënda penale, ata në moshë të madhe, ose ata që në momentin e kryerjes së veprës kanë qenë më të vegjël se 18 vjeç.

PËRFITUESIT
Projektligji i Ministrisë së Drejtësisë dhe i konsultuar edhe me prokurorinë parashikon që të amnistojë të gjithë personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën, pezullimin e dënimit me burgim ose çdo lloj dënimi tjetër alternativ, për dënime të dhëna deri në datën kur hyn në fuqi ligji.
2. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit u kanë mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 vjet.
3. Amnistohen personat e dënuara femra, që në datën e hyrjes në fuqi të ligjit janë bars ose mbi moshën 55 vjeçe.
4. Amnistohen personat e dënuar meshkuj, që në datën e hyrjes në fuqi të ligjit janë bars ose mbi moshën 60 vjeç.
5. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë bars ose nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të atyre që janë dënuar për vepra penale të konsideruara të rënda.

TË BURGOSURIT QË PËRFITOJNË

1. Amnistohen personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën, pezullimin e dënimit me burgim ose çdo lloj dënimi tjetër alternativ, për dënime të dhëna deri në datën kur hyn në fuqi ligji.
2. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit u kanë mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 vjet.
3. Amnistohen personat e dënuara femra, që në datën e hyrjes në fuqi të ligjit janë bars ose mbi moshën 55 vjeçe.
4. Amnistohen personat e dënuar meshkuj, që në datën e hyrjes në fuqi të ligjit janë bars ose mbi moshën 60 vjeç.
5. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë bars ose nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të atyre që janë dënuar për vepra penale të konsideruara të rënda.

VEPRAT QË PËRJASHTOHEJN NGA AMNISTIA

- Nuk përfitojnë nga kjo amnistia personat e dënuar për:
- a) Krime kundër njerëzimit, të parashikuar në nenet 73, 74, 74/a e 75 të Kodit Penal.
 - b) Krime kundër jetës me dashje të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/c, 81, 82, 83/a, 83/b e 84/a të Kodit Penal, si dhe në nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak.
 - c) Për vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit të parashikuar në nenet 86, 97, 88, 89/a, e 99 të Kodit Penal.
 - d) Krime seksuale të parashikuara në nenet 100, 101, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe 108/a të Kodit Penal.
 - e) Vepra penale kundër lirisë së personit të parashikuar në nenin 114 dhe në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 109/b dhe 109/c; në paragrafin e dytë të nenit 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal.
 - f) Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuar në nenin 114 dhe në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 117 të Kodit Penal.
 - g) Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 124, paragrafin e dytë e të tretë të nenit 124/b; në nenin 128/a, 128/b e 130/a të Kodit Penal.
 - h) Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve të parashikuara nga nenet 325 deri në 331.

INDALESAT
Projektligji parashikon se nuk mund të përfitojnë nga amnistia të dënuarit për krime kundër njerëzimit, krime seksuale, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vrasje me pararendim apo me dashje, si dhe ata që kanë kryer vepra penale kundër fëmijëve, martesës ose familjes, si dhe për korrupsion të

që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë bars ose mbi moshën 60 vjeç.

PËRJASHTIMI
Por, pavarësisht faktit nëse i plotëson ose jo kriteret e mësipërme, projektligji bën edhe një sërë ndalesash, duke përjashtuar një kategori të madhe veprash, të cilat nuk mund të amnistohen. Kështu, projektligji parashikon se nuk mund të përfitojnë nga amnistia të dënuarit për krime kundër njerëzimit, krime seksuale, vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, vrasje me pararendim apo me dashje, si dhe ata që kanë kryer vepra penale kundër fëmijëve, martesës ose familjes si dhe për korrupsion të zyrtarëve. Po ashtu, nuk do të kenë mundësi të përfitojnë as personat e dënuar me vendim të formës së prerë për krime që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Amnistia për të burgosurit rikthehet pas më shumë se 2 vitesh. Për herë të fundit të dënuarit kanë përfituar lirinë në vitin 2016, kur lanë qelitë mbi 700 të burgosur. Ndërsa në 2017-ën dhe 2018-ën amnistia nuk u aplikua. Të drejtën për të amnistuar të dënuarit e ka edhe presidenti. Nga ana e tij, kreu i shtetit, Ilir Meta ka paralajmëruar se nuk do amnistojë asnjë të dënuar për vepra penale si dhunë në familje apo dhe krime seksuale.

Gjonaj: Jo më lekë për trajtimin e të burgosurve në spitale private

Aj shtë një kosto shtesë nga buxheti i shtetit për të burgosurit që kanë nevojë për trajtim mjekësor të specializuar në spitale private. Kjo, pasi qendra spitalore e burgjeve pas rikonstruksionit total ofron të gjitha kushtet për trajtimin e të burgosurve brenda saj. Ministria e Drejtësisë inspektoi kushtet e reja nga investimi 29 milionë lekë dhe bëri me dije se shpejt do t'i japë zgjidhje edhe gangrenës në vite të të dënuarve me mjekim të detyruar, që vuajnë dënimin në kushte skandaloze në burgun e Zaharisë në Krutje. "Shërbimi kryesor në IVSHB është ai i kujdesit shëndetësor dhe psikologjik, ku zhvillohen biseda në grup, seanca terapeutike për personat me probleme shëndetësore dhe do të jetë një frymëmarrje për të gjithë sistemin penitenciar. Gjatë rikonstruksionit janë kryer ndërhyrje jashtë dhe brenda qendrës spitalore, në çdo kat, në çdo pavijon (kirurgjia, patologjia, infektiviteti, psikiatria) dhe në çdo dhomë. Tashmë, falë këtij investimi, 100 të dënuar/pacientë do të trajtohen në kushte optimale, me standarde të larta", - tha Gjonaj.



Ajo bëri të ditur se synimi është ulja e mbipopullimit në burgje dhe për këtë ajo theksoi se qeveria ka ndërmarrë disa investime. "Së shpejti përfundon edhe rikonstruksioni i godinave 4 dhe 5 në IEVP Lezhë, të cilat do të shërbejnë si një spital i përkohshëm për personat me vendim gjykatë mjekim i detyruar. Me përfundimin e rikonstruksionit të kësaj strukture, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Shëndetësisë, do të krijohen kushtet e përshtatshme për trajtimin e personave që aktualisht ndodhen në IEVP Krutje. Gjithashtu, kemi bërë ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të jetesës edhe në IEVP Peqin dhe Burrel, investime të cilat do të vijojnë edhe në elementë të tjerë të sigurimit dhe përmirësimit të shëndetit", - tha Gjonaj.

SHPLLJE ANKANDI
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me Përmbarues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. "Ibrahim Rruova", Pallati 64, Hyrja B, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 03.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandit i për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme, Ndërtësit me sipërfaqe totale 186 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Shkodër me Nr.pasurie 2/613+1-6, Volumi 37, Façe 232, Zona Kadastrale Nr. 8591 në pronësi të Z.Allfred Lec Mazi me vlerë fillestare në ankand 100.000 (njëqind mijë) EURO.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672207580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com;

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Perbarimore L.D.C
"Truall + ndërtesë" me nr. pasurie 286/5/1, vol.3, façe 36, Zona Kadastrale 3866, me sipërfaqe totale 300 m², regjistruar në Z.V.R.P.P. Tiranë. Çmimi fillestar për shlyerje është 1.800.000 Lekë.
Data e shpalljes 27.02.2019
Data e zhvillimit 28.03.2019 deri në orën 16.00
Ankandit zhvillohet në ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
Përmbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbarues Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasurinë:
1- Truall, me sipërfaqe 250 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 85m² e ndodhur në Bitnckë, Devoll, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 1831/50, Vol. 20, Façe 70, në pronësi të Vasil Ferit Mucsku Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 5.600 (peshmje e gjashtëqind) EURO ose 700.000 (shtatëqind mijë) LEKE.
Ankandit i dytë për pasurinë e mësipërme zhvillohet më datë 17.04.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrrës së përmbarueses gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 069381883 .

Ngjarja në qendër të qytetit, autorët e krimit i vënë flakën "Benzit" të vjedhur pranë Bradasheshit

ELBASAN

Tronditet Elbasani. Një 50-vjeçar është ekzekutuar me plumb pas koke në qendër të këtij qyteti. Bëhet fjalë për avokatin e njohur Ravik Gurra, i cili ka mbrojtur çështje të bujshme si ajo e Shullazit dhe Çapjave. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në një lokal të njohur në këtë qytet, ndërsa dyshohet se autori ka qenë i maskuar. Burime policore bëjnë me dije se avokati ka qenë duke pirë kafë në ambientet e lokalit kur është qëlluar për vdekje me armë zjarri. Mësohet se Gurra ishte i shoqëruar me dy persona të tjerë në tavolinë, njëri prej të cilëve, gjithashtu, avokat. Menjëherë pas sinjalizimit për vrasjen, forca të shumta policore kanë mbërritur në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorit/ve të krimit. "Rreth orës 19:35, në një lokal në Elbasan, nga persona ende të paidentifikuar është vrarë me armë zjarri shtetasi R.G., 50 vjeç, banues në Elbasan. Shërbimet e Policisë kanë ngritur pika kontrolli në të gjitha rrugët në hyrje e dalje si dhe po krehin zonën ku dyshohet se janë larguar autorët. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po grumbullon e fikson çdo provë që do shërbejë për zbardhjen e ngjarjes. Një grup ekspertësh nga Departamenti i Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit është nisur menjëherë në ndihmë të grupit hetimor për të bërë të mundur zbardhjen e shpejtë të ngjarjes", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Gjithashtu, në Elbasan kanë zbkruar dhe RENEKA, e cila ka nisur kontrollin me qëllim kapjen e autorëve.

Ndërkaq, burime nga vendi i ngjarjes pohuan se autori i krimit i është afruar avokatit Ravik Gurra dhe pa i folur e ka qëlluar atë në kokë me pistoletë me silenciator. Më pas vrasësi është larguar nga vendi i ngjarjes me një automjet që e priste. Vetëm pak minuta pas krimit që tronditi banorët e qytetit të Elbasanit, u raportua për një makinë që po digjej në fshatin Karakullak, pranë Bradasheshit. Mësohet se automjeti i djeur është tip Benz me targa AA 934 HU dhe rezultoi të jetë vjedhur në Fushë-Krujë. Ndërsa, dyshohet që autorët menjëherë pas krimit janë larguar me këtë makinë, të cilës i kanë vënë zjarrin për të humbur gjurmët. Nuk dihen shkaqet e vrasjes së avokatit, por nuk përjashtohet pista për shkak të detyrës. Burimet e mësipërme pohuan për "Gazeta Shqiptare" se po hetohet në disa pista në lidhje me ekzekutimin e avokatit Gurra. Mësohet se pistat kryesore ku është përqendruar hetimi është raporti i viktimit me fisin Çapja në Elbasan si dhe me atë të Emil-

Ekzekutohet me plumb në kokë avokati i Shullazit e Çapjave

50-vjeçari Ravik Gurra u qëllua në lokal me pistoletë me silenciator



Avokati i vrarë, Ravik Gurra



Lokali ku ndodhi vrasja

iano Shullazit, pasi këtë të fundit e kishte përfaqësuar në gjyq. 50-vjeçari Gurra njihet për miqësinë me fisin Çapja, si dhe i përfaqësonte në procese gjyqësore, e po

kështu edhe Emiliano Shullazin. Nga ana tjetër, dëshmitarë ngas vendi i ngjarjes u shprehën se çdo gjë ka ndodhur shumë shpejt dhe se nuk kanë kuptuar asgjë.

Ata kanë thënë se janë përfshirë nga paniku vetëm kur kanë parë trupin e shtrirë të avokatit të njohur.

Ravik Gurra ishte shtetas anglez, ndërsa bënte

një jetë mes Shqipërisë ku kishte familjen dhe Britanisë. Mësohet se ai sot do të nisej për në Londër. Në Elbasan ai jetonte vetëm me nënën, pasi me gruan ishte

divorcuar. Ndërkohë që dy prokurorët që kanë marrë në dorë zbardhjen e dosjes janë Enkelelda Millonai dhe Pefref Asllani.

Vrasja e Ravik Gurrës, Dhoma e Avokatisë: Jemi të tronditur, organet ligjzbatuese të kapin autorët

TIRANË - Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në qendër të qytetit të Elbasanit ku mbeti i vrarë avokati Ravik Gurra ka reaguuar Dhoma e Avokatisë. Kreu i Dhomës së Avokatisë Maksim Haxhia shprehet i tronditur,

ndërsa i kërkon policisë të vendosë para drejtësisë autorët e krimit. "Dhoma e Avokatisë të Shqipërisë, nëpërmjet mediave u vu në dijeni të vrasjes me armë zjarri të avokatit Ravik Gurra, anëtar i Dhomës të Avokatisë Tiranë. Jemi të tronditur thellë nga kjo ngjarje, me shqetësim dhe indinjatë të thellë ju kërkon organet ligjzbatuese duke i dhënë përparësi gjetjes dhe vënies para përgjegjësisë të autorëve të kësaj veprë e cila vjen e bëhet çdo ditë më prezente në kërcënim të jetës dhe shëndetit ndaj avokatëve, veprime që kanë marrë përshkallim në rritje ndaj profesionit sa të nderuar aq edhe fisnik të avokatit. Për Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë, Prof. Dr. Maksim HAXHIA", thuhet në reagim.



Java e "zezë", 4 të vrarë në 7 ditë në Tiranë, Shkodër dhe Elbasan

Brenda 7 ditëve janë vrarë katër persona në rrethet e ndryshme të vendit tonë.

Mbrëmjen e 16 marsit u vra tekta ishte duke shëtitur pranë Liqenit Artificial në Tiranë, 62-vjeçari Haxhi Baçinozi, ish i përndjekur politik.

Mbrëmjen e 18 marsit u ekzekutua ish-menaxheri i VIP-ve, Jurgen Kurti po në kryeqytet, te stadiumi "Selman Stërmasi", në hyrje të pallatit ku banonte. Pasditën e së mërkurës, më 20 mars u vra në fshatin Grudë të Shkodrës biznesmeni nga Thethi, Ferdinand Polia, i njohur si "Nardi i Bujtinave". Mbrëmjen e 22 marsit, u ekzekutua në qendër të qytetit të Elbasanit avokati i njohur Ravik Gurra

Kavajë, e plagosi me çifte pas konfliktit për pronën, vdes në spital pronari i furrës së bukës

KAVAJË - Një 59-vjeçar nga Kavaja ka humbur jetën sot në spital, shtatë ditë pasi u qëllua me çifte. Bëhet fjalë për shtetasin Esat Kotorri, i cili ishte pronar i një furre buke në qytetin e tij. Kjo ngjarje ndodhi rreth orës 05:00, në lagjen "Zguraj", ku i dëmtuari Esat Kotorri sapo kishte hapur dyqanin. I dyshuari për ngjarjen është një 26-vjeçar, i cili u vu në pranga nga policia e Kavajës pak kohë pasi plagosi me çifte Kotorrin. Nga të dhënat e siguruar nga policia dhe grupi hetimor në Kavajë, dyshohet se shkak i krimit është bërë një konflikt i hershëm mes pronarit të furrës së bukës dhe familjes së autorit. Sipas bluve i dyshuari është Seferjan



Esat Kotorri

“

NGJARJA

Sipas bluve i dyshuari është Seferjan Troka. Në momentin kur ndodhi ngjarja, i plagosuri ndodhej në ambientet e brendshme të furrës bashkë me të shoqen dhe po përgatisnin produktet për ditën e premtë.

Troka. Në momentin kur ndodhi ngjarja, i plagosuri ndodhej në ambientet e brendshme të furrës bashkë me të shoqen dhe po për-

gatisnin produktet për ditën e premtë. Ndërsa autori i dyshuar i ngjarjes, me sa duket, ka qenë duke e pritur të dëmtuarin derisa të futej brenda dyqanit dhe më pas është futur në kuzhinë duke qëlluar me armë gjahu në drejtim të tij. Ka qenë bashkëshortja e Kotorrit, që ka lajmëruar menjëherë policinë, por edhe ka bërë të mundur identifikimin e autorit, duke qenë se ka parë të gjithë skenën. Fatmirësisht, ajo nuk ka pësuar asgjë nga sulmi me armë. Ndërsa i plagosuri është transportuar menjëherë në spital, ku mësohet se dhe ndërroi jetë pas një jave.



Në kërkim për pastrim parash, arrestohet në Rinas indiani 59-vjeçar, Hitesh Patel

TIRANË - Një 59-vjeçar indian i shpallur në kërkim ndërkombëtar për pastrim parash është ndaluar dje në Rinas nga Interpol Tirana. Bëhet fjalë për Hitesh Patel, lindur në Indi dhe banues në Nigeri, i cili u kap pasi tentoi të largohej nga Shqipëria. 59-vjeçari akuzohet për mash-

trim të kredive bankare, të cilat i përfitoi përmes kompanisë "Sterling Biotech" me bazë në Indi. Sipas TV "Klan", Patel ka qenë një nga drejtuesit më të lartë të kësaj kompanie dhe sipas mediave indiane, njihet si personi që krijoi një skemë të madhe të mashtrimit financiar, duke

përfituar rreth 1 miliard dollarë në mënyrë të jashtëligjshme. Interpol India lëshoi mandatin e arrestit për të në 11 mars. Sipas "Times of India", agjencitë ligjzbatuese të Indisë kanë nisur menjëherë kontaktet me Interpolin dhe autoritetet shqiptare për të nisur sa më parë proce-

durat e ekstradimit. 59-vjeçari është kuni i vëllezërve indianë Nitin dhe Chetan Sandesara, të cilët zotërojnë grupin "Sterling Biotech Group". Mësohet se autoritet indiane kanë dyshime se vëllezërit Sandesara ishin arratisur në Nigeri, por prej shkurtit të vitit të kaluar, ata janë bërë shtetas shqiptarë dhe janë duke investuar në ndërtimin e pallateve në kryeqytet, por edhe në bregdetin shqiptar. Për këta persona mësohet se nuk ka një urdhër ndërkombëtar arresti.

Dyshohet që atentati ndaj biznesmenit të ketë lidhje me të kaluarën e tij

SHKODËR

Tri ditë pas atentatit të ndodhur në fshatin Grudë të njësisë administrative Gruemirë, ku u ekzekutua me breshëri automatiku biznesmeni Ferdinand Polia, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen. Dyshohet se vrasja e 32-vjeçarit nga Thethi (njihej ndryshe dhe si "Nardi i Bujtinave") ka lidhje me të kaluarën e tij. Mësohet se Ferdinand Polia kishte vetëm 4 vite që ishte kthyer nga Italia, ku kishte emigruar kohë më parë. Pas kthimit në vendlindje, ai u përkushtua turizmit malor, aty ku kishte edhe një bujtinë, por pas kishte një të shkuar problematike. Ai rezultoi se ka disa precedentë penalë në vendin fqinj, pasi është akuzuar për trafik droge, shfrytëzim prostitucioni si dhe për grabitje me dhunë të ndodhura në Treviso dhe Venecia. Gjatë kohës që ka qenë emigrant në Itali, referuar asaj që shkruajnë mediat italiane, ai është akuzuar për pjesëmarrje në një grup që trafikonte kokainë, por edhe vjedhje.

ARRESTIMI NË ITALI

Ai është arrestuar në vitin 2010-të, në kuadër të operacionit "Treviso cleaning", si pjesë e një grupi shpërndarësish kokainë në lokalët e Trevisos, por edhe Venecias. Një vit më pas, në 2011-ën, Polia 24-vjeçar u dënua me 4 vite burg. Mediat raportojnë se në atë kohë, banda pjesë e së cilës ishte kishte arritur të fitonte nga shitja e kokainës deri në 800 mijë euro. Në rastet kur klientet femra nuk kishin para, në këmbim pranohej dhe kryerja e marrëdhënies seksuale. Në një rast grupi kishte arritur të fuste në kurth një vajzë 17 vjeçe në Treviso, madje i kishin kërkuar asaj që t'u prezantonte shoqe të virgjëra. Në total, si pjesë e grupit u arrestuan 12 persona, ku gjysma e tyre ishin shqiptarë. Por, ndërkohë që ndodhej në burg, hetuesit italianë zbuluan edhe disa ngjarje të tjera, ku Polia ishte përfshirë. Përveç trafikut të drogës, ai kryente edhe vjedhje.

PROCEDIMI NË Vendlindje

Me t'u kthyer në Theth në vitin 2015-të, Ferdinand Polia u kthye në një nga njerëzit më të dashur për zonën, madje u bë edhe pjesë e administratës shtetërore, duke u emëruar administrator i Zonave të Mbrojtura në Parkun Kombëtar të Theth-

U vra me breshëri plumbash, zbulohet e shkuara e errët e "Nardit të Bujtinave"

32-vjeçari, me precedentë penalë në Itali për trafik kokaine, vjedhje e shfrytëzim prostitucioni



Biznesmeni i vrarë, Ferdinand Polia



it. Në vitin 2017 rezultoi të jetë proceduar penalisht në gjendje të lirë bashkë me kryepalokun e Thethit, për shkak se policia konstatoi një parcelë me kanabis në këtë zonë. Megjithatë, reput-

acioni që kishte në zonë si një njeri që punonte për të mirën e komunitetit vijon të jetë i fortë edhe sot. Policia e Shkodrës po heton për të kaluarën e tij si një nga pistat për vrasjen, por nuk përjas-

htohen as konflikte të reja ku biznesmeni 32-vjeçar mund të jetë përfshirë. Pasditën e së mërkurës kur u ekzekutua, ai sapo kishte dalë nga një servis në fshatin Grudë të njësisë adminis-

trative Gruemirë, ku kishte çuar fuoristradën e tij për t'u lyer. Autori që i kishte zënë pritë, pasi e qëlloi për vdekje me 18 plumba, dogji motorcikletën pak metra larg vendit të ngjarjes dhe u zhduk.

Shkalla e Parë kishte pushuar çështjen ndaj biznesmenit

U akuzua për mashtrim nga banorët e "Unazës së Re", Apeli tërhiqet nga ankimi për Namik Pelivanin



se një viti hetimesh, të çelura pas kallëzimit të disa familjeve në zonën e "Unazës së Re". Nga hetimet u provua se i pandehuri nuk kishte respektuar kontratën e lidhur me pronarët e truallit, të cilëve u kishte shembur shtëpinë, për

të ndërtuar në tokën e tyre një pallat shumëkatesh. Në shenjë revolte ndaj administratorit, pjesëtarët e familjeve të mashtruara disa herë janë ngjitur në tarracën e pallatit, duke kërcënuar se do të flijoheshin nëse nuk gjenin drejtë-

si. Ndërsa banorët protestonin në korrik të 2016, prokuroria shpalli pretendencën, duke kërkuar dënimin e Namik Pelivanin me 12 vite burg, e duke argumentuar se kishte prova e fakte për fajësinë e tij. Megjithatë, kërkesa e prokurorisë u rrëzua nga gjykata, e cila vendosi pushimin e çështjes për biznesmenin. Vendimi në fjalë u kundërshtua nga prokuroria, e cila bëri ankim në Apel, me argumentin se gjykata nuk kishte vlerësuar drejt provat e faktet ndaj të pandehurit. Në shkallën e dytë të gjyqësorit kërkohet prishja e vendimit të gjykatës së Tiranës dhe dënimin i të pandehurit Pelivani me 12 vite burgim. **kl.la**

SHKURT

Protesta e 16 shkurtit, lihet në burg Florenc Hoxha

TIRANË - Gjykata e Tiranës i ka rrëzuar kërkesën për ndryshimin e masës së sigurisë "Arrest me burg" për ish-kreun e INUV, Florenc Hoxha, i cili u arrestua si i dyshuar për akte të dhunshme gjatë protestës së 16 shkurtit në Tiranë. Bashkë me Hoxhën mbetën në burg dhe shtetasit Ferit Dankshi, Agim Peposhi, Ilir Hamendani dhe Sajmir Rexhepi. Arrestimi i tyre u bë në bazë të pamjeve filmike të policisë si dhe ato të vendosura në Kryeministri, të cilat kanë fiksuar të gjitha veprimet e protestuesve. Identifikimi i tyre u bë në kohë rekord nga efektivat e policisë së kryeqytetit, por edhe agjentët e krimeve, të ardhur nga rrethet të cilat kanë verifikuar veprimet e tyre. Gjatë seancës gjyqësore që u zhvillua dy ditë më parë, avokati Ivi Kaso deklaroi se do ta apelojmë vendimin, pasi është i padrejtë dhe i papabuar në ligj. Ndërsa, gjatë seancës gjyqësore të 19 shkurtit, Hoxha deklaroi se do të vazhdojë rezistencën e tij deri sa kjo qeveri të largohet. Mes tjerash, ish-kreu i Policisë Bashkiake hodhi akuzat të forta ndaj FNSH-së për dhunën e ushtruar gjatë shoqërimit në prani të familjarëve dhe dy fëmijëve.

Grabitet me armë makina, policia e gjen të djegur

LEZHË - Një makinë tip "Benz" është grabitur dhe i është vënë flaka nga dy persona të maskuar dhe të maskuar dhe të armatosur. Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e së enjtes në hyrje të rrugës së fshatit Kakarriq, vetëm pak metra nga superstrada Lezhë-Shkodër. Mësohet se pronari i automjetit me targa AA377 KH është Nikolin Kola, punonjësi i Bordit të Kullimit. Gjatë marrjes në pyetje, Kola ka deklaruar se nuk i ka njohur grabitësit dhe nuk ka dijeni për motivin e djegies së makinës. Kola po shkonte në banesë në momentin e ngjarjes, kur dy maskat, nën kërcënimin e armëve e goditën me sende të forta duke i vjedhur edhe automjetin. Dy km larg vendit të ngjarjes, agresorët i vunë flakën makinës.

"Kujdes, vetëm nëse kaloni këtë testim mund të konkurroni për më tej"

Votliza Duro

Përgjatë muajit prill, infermieret e rinj do t'i nënshtrohen provimit të aftësimit praktik VAP. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot emrat e 1230 infermierëve që do të testohen së bashkë për këtë testim...

Provinci, lista e plotë me 1230 kandidatët në Infermieri

Urdhri i Infermierit, test mbi aftësitë profesionale

femierit ndryshoj kushtet për të gjithë kandidatët që dëshironin të hyjnë në provincin e shtetit. Sipas këtyre ndryshimeve, të interesuarit, përveç praktikës profesionale, i nënshtrohen një testimi profesional në fund të saj, ndërkohë që vetëm

nëse vlerësohen pozitivisht në të, kanë të drejtë të regjistrohen për provincin e shtetit. Konkretisht, studentit i diplomuar në programet e studimit të sipërpërmendura, ditën që regjistrohet, merr librezën e praktikës profesionale.

Në këtë librezë mbahen shënimet ditore përgjatë 12 javëve që studentit i realizon praktikën, të cilat firmosen çdo ditë nga drejtuesit i saj. Në fund, librezë e firmosur nga drejtuesit vlerësohet me një numër pikësh të caktuara. Saktësisht, ato

janë nga 10 deri në 25 pikë, të cilat i njihen kandidatit gjatë realizimit të testimit profesional. Ai e merr librezën, dhe 10 ditë para datës së provimit e dorëzon atë pranë Urdhrit profesional dhe regjistron për dhënien e testimit profesional.

KANDIDATËT NË INFERMIERI

INFERMIERI VAP DATA 01.04.2019 ORA 08.30

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 01.04.2019 at 08.30.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 02.04.2019 at 08.30.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 02.04.2019 at 08.30.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 02.04.2019 at 08.30.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 02.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 03.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 03.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 03.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 01.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 01.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 01.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 01.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 01.04.2019 at 11.00.

Table with 3 columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi. Lists candidates for the VAP exam on 01.04.2019 at 11.00.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 08.04.2019 ORA 11.00.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 04.04.2019 ORA 11.00.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 04.04.2019 ORA 13.00.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 05.04.2019 ORA 11.00.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 06.04.2019 ORA 08.30.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 08.04.2019 ORA 11.00.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 04.04.2019 ORA 08.30.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 05.04.2019 ORA 08.30.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 05.04.2019 ORA 13.00.

Table with columns: Nr, Emri, Mbiemri, Kodi, and a list of names and IDs for the INFIRMIERI VAP DATA 06.04.2019 ORA 13.00.

Ndërtuan në tokën e shtetit ose të të tretëve, marrin tapitë për tokën

Lista me 600 pronarë që u miratohet e drejta mbi truallin

Përfituesit Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë

Miratohet lista me personat që kanë ndërtuar pa leje dhe fitojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqet ndërtimore. Me një vendim të veçantë, qeveria ka përcaktuar metra katrorë për parcelat ndërtimore në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë. Janë 600 përfitues në të gjithë vendin, të cilët do të marrin tapitë për truallin mbi të cilin kanë ndërtuar. Në listën e miratuar nga qeveria janë përcaktuar sipërfaqet për çdo përfitues, ndërsa ngarkohet ALUIZNI për pasqyrimin e tyre në dokumentet përkatese. Përfituesit do të mar-

rin tapitë për sipërfaqet e përcaktuara në VKM, pavarësisht sipërfaqes që kanë deklaruar në procesin e vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje. Përfituesit kanë mbyllur të gjithë detyrimet dhe

pritet të marrin tapinë për tokën.
KALIMI I PRONËSISË
Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje bëhet sipas dispozitave të

Kodit Civil. Sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funk-

sion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim i shiten

poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

PRONARËT QË U MIRATOHET E DREJTA MBI TRUALLIN

432	ISMET	SELMA	MALI	200
433	QAMIL	ALI	HAXHIMALI	399.6
434	ARBE	MUHAR	TARJA	180
435	BILAL	MUHAR	TARJA	327.9
436	ARTAN	SHEQY	SPAHIU	479.1
437	LULZI	BARDH	HOXHA	408
438	FADIL	ADEM	KASA	274.2
439	GEZIM	VESEL	RRUMBULLAKU	356.7
440	ZYDI	HASAN	QOKU	432.6
441	DHURA	DEMIR	ELEZAJ	140
	INES	HYSNI	ELEZAJ	
442	SELIM	TAG	HYSA	177.6
443	ARJAN	ZYHDI	LAMAJ	358.2
	XHEVRI	XHEM	PETKU	
	SUL	ASLLA	PETKU	
	ISMET	ASLLA	PETKU	
444	FEHMI	ASLLA	PETKU	500
445	HEKUR	XHEMA	KOTARJA	294.3
446	YLLI	DULBI	KURTI	289.2
447	ARJAN	BASHKI	KETA	298.8
448	JANAQ	VASIL	RISTANI	333.2
449	DASHNO	SABRI	XHEMALI	489.9
450	ISMAIL	HASAN	DERVISHI	423.9
451	ALFRED	AFES	KUME	207.9
452	LULZIM	KADRI	MULLETI	321.3
453	TRENDAF	KAMBER	MILLOSHI	339.9
454	ALTIN	AZEM	RRENJOLLARI	206.6
455	KRESHNI	ASLLAN	CANKO	226.8
456	HAJREDI	HAMIT	FUÇIA	85.4
457	SULEJMA	SHEQYR	KULLOLLI	333.3
458	ZABIT	SABRI	FERATI	261.9
459	NAIM	RAMAZA	VELLJA	300.3
460	PETRIT	ISLAM	OZUNI	258
461	LUAN	JONUZ	TROKSI	396
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1605,ZVRPP TIRANE				
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3866,ZVRPP				
463	HYSE	SUL	AXHAMI	197.7
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2105,ZVRPP TIRANE				
466	AJET	XHEVD ET	ALUKU	500
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2119,ZVRPP TIRANE				
	IDAJE T	RRAH MAN	ÇEÇA	232.2
467	KURTISH	RAHIM	OSMANLLARI	321.3
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1377,ZVRPP TIRANE				
468	BARDHO	KOL	KAÇORRI	388.8

QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976,ZVRPP TIRANE				
469	LULZIM	HAMDI	HASA	264
470	ZYBER	RESHI	LIKA	307.2
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1906,ZVRPP TIRANE				
471	PETRIT	XHEMA	DERVISHI	381.9
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1498,ZVRPP TIRANE				
472	GAZMEN	ZYHDI	HAXHIASI	363.6
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3714,ZVRPP TIRANE				
473	LULZIM	HYSNI	ROBETA	238.5
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2953,ZVRPP TIRANE				
474	AGRON	BAJRA	TERZIA	291.9
475	Myftar	Nezir	Xhelili	98.7
476	Sokol	Selman	Habilaj	276
	Themisto	Thanas	Kreko	
	Shpresa	Gani	Beqo	
477	Suzana	Timoleo	Meritri	6.2
	Lefter	Anastas	Thomajini	
	Thodhor	Faslli	Beduli	
478	Benet	Ruhan	Omeri	290
	Rodolf	Ruhan	Omeri	
479	Arben	Mane	Guga	33.4
480	Alem	Selfo	Hoxha	383
481	Janaq	Pano	Kuçi	405
482	Julian	Gjike	Roshi	432
483	Vasil	Asllan	Konomi	327
484	Jorgo	Thanas	Marku	23
485	Eftali	Niko	Qurku	110
	Kase	Hetem	Isufi	
486	Shaqir	Mezan	Isufi	3
487	Llazar	Sotir	Angjeli	90
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8642 ZVRPP SARAJ				
488	Jorgo	Nikolla	Papa	195.88
489	Laureta	Premul	Mato	93
490	Maldona	Premul	Hysa	76
	Petrit	Sefedin	Poda	
491	Raime	Skende	Poda	15.2
492	Jakup	Xhemal	Ali	346.98
493	Arsi	Astrit	Zejno	500
494	Avenir	Nazmi	Demi	220
	Enise	Lufi	Demi	
495	Shkelqim	Dano	Muskaj	606
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8642, 8641 ZVRPP				
	Duka	Meno	Demiri	
	Mezar	Feti	Mehmeti	
	Sokol	Mezan	Meleqi	
496	Emilia	Foto	Kovi	50
497	Rexhin	Shpeti	Dauti	500
498	Perparim	Teme	Memlika	364
499	Luan	Sali	Sali	384
	Luiza	Izet	Rrapaj	
500	Çaush	Agim	Rrapaj	300

501	Arjan	Pando	Mano	254.79
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8642, ZVRPP				
502	Angjellos	Avni	Fataj	350
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8642, 8641 ZVRPP				
503	Ardian	Idris	Mucobega	319
504	Dashnor	Hamit	Lazaj	303
505	Nafiz	Çerçiz	Sinani	300
506	Lefter	Lamçe	Kuspa	496
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 3832 ZVRPP SARAN				
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 2264 ZVRPP SARAN				
507	Elton	Petro	Sullaj	500
	Spiro	Mico	Sterjo	
	Vasillo	Thoma	Sterjo	
509	Mihal	Thoma	Kaishi	143.6
510	Jorgo	Koci	Muka	218
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 2297 ZVRPP SARAN				
QARKU VLORE, ZONA KADASTRALE 8642, 8641 ZVRPP S				
511	Gezim	Ramada	Mollanji	107
512	Daut	Qamil	Daci	286
	Ferdinand	Manol	Merkuri	
	Ferdinand	Manol	Merkuri	
	Ziso	Thodhori	Anagnosti	
	Kristo	Panajot	Kiço	
	Irodhi	Nasho	Dalani	
	Irodhi	Nasho	Dalani	
	Nuri	Nimet	Shenaj	
	Selam	Muharre	Xhelilaj	
	Bilal	Idris	Ahmeti	
513	Spiro	Vasil	Gjirkopulli	158
513	Çlirim	Hetem	Halili	400
514	Leni	Birçe	Koka	266
	Irena	Shefik	Gjika	
515	Jani	Faik	Papaj	49
516	Spartak	Mezar	Alushi	303
517	Spiro	Sulo	Dalani	49
518	Ilia	Pilo	Qesko	206
519	Kujim	Sami	Meçani	315
520	Shahin	Dalan	Sadiku	408
521	Kosta	Gligor	Kaçi	267
522	Jani	Hysen	Salaj	197
523	Dhimit	Xhelal	Telo	282
524	Lazaros	Selfo	Beqo	238
525	Sadik	Xhemil	Sadiku	300
526	Mario	Tajjar	Beka	496
527	Alban	Isa	Llodos	417
	Bajra	Selma	Bardho	
	Mihal	Bajram	Bardho	
	Sotir	Bajram	Bardho	
528	Shkelqi	Bajram	Bardho	500
529	Majlind	Vasil	Thodhori	64.5

KRITIKA

Kreuztanne, ose kur lepuri i madh doli nga shkurret e vogla

Bozidar Prosenjak

Romani KREUZTANNE - Udhëkryqi, shkruar nga shkrimtari, piktori dhe fotografi shqiptar, Fate Velaj, u përkthye në kroatisht nga gjermanishtja nga Boris Peric dhe u vendos qysh në fillim të kolana prestigjioze e bibliotekës "Alfa", tek "Dobra prosa" ose "prozë e Mirë", duke i dhënë kështu publikut lexues kroat, veçanërisht për njohësit e zhvillimeve të mundësive letrare kroato-shqiptare të epokës/kohës të re, privilegjin të njihen me këtë autor tejet interesant dhe veprën e tij shumëpalëshe. Fate Velaj si person dhe romani i tij "Udhëkryq" si veprë, me paraqitjen e tyre provokojnë kureshtje. Jam mëse i bindur se lexuesi vendas do të ketë rastin të krahasojë veçoritë (ngjashmëritë dhe dallimet) e letërsisë kroate dhe asaj shqipe, si dhe të zbulojë rreth arrieteve të prozës shqipe të kohëve të fundit. Sfaqja e këtij libri, me siguri do të ketë një jehonë të caktuar për lexuesit, brenda dhe mbanë kufijve e mjedisve letrare të Ballkanit të cilët, autorët e këtij rajoni, shpesh i perceptojnë si një masë të padallueshme, gati amorfe e me efekt të paqartë. Në domenin e kulturës dhe artit të gjuhëve të mëdha botërore (është fjala për popujt të mëdhenj në numër - anglisht, gjermanisht, frëngjisht, rusisht ... - mbizotëron mendimi i zakonshëm se, "lepuri i madh mund të dalë vetëm nga një shkurre e madhe". Kështu, nga literatura e të ashtuquajturve popujt të vegjël, nuk pritet që dalja e një veprë të tërheqë aq shumë vëmendjen e publikut të gjerë.

Prandaj, surprizat e kënaqshme janë edhe më të mirëseardhura. Romani i Fate Velaj "Udhëkryq" është një tregim për jetën e një emigrantit të ri shqiptar që kërkon vendin e tij nën diell, në Austri. Ndoshta është kjo, në kuptimin më të mirë një histori evropiane - përgjigje e ofruar për pyetjen ende të hapur të civilizimit për të arritur forcën kohezeve brenda komunitetit të kombeve evropiane (Evropës së Bashkuar). Si një shqiptar, i cili është me zemër, më saktë me rrënjë i lidhur pazgjidhshmërisht



me atdheun e tij Shqipërinë, mundet në të njëjtën kohë të jetë jo vetëm funksionale, por një pjesëtar i dedikuar me shpirt i komunitetit të ri shoqëror dhe politik, ku ai gjeti shtëpinë e tij të re, gjuhën e të cilit, kulturën dhe ligjet i ka pranuar me respekt të plotë si të tijat. Romanet për emigrantët shpesh flasin për jetën e vështirë që kalojnë dhe për vuajtjet që ata përjetojnë, të ndarë nga vendi i tyre i lindjes, duke u ndjerë përgjithmonë të huaj në atë pjesë tjetër të botës. Dhe ja çudia, ky roman, në të vërtetë, duke mos fshehur dhimbjen dhe lotët, sepse nëna e tjetrit nuk është nëna jote, nuk ngjan aspak me të parët. E kundërt, personazhi kryesor është njeri që e ka qetësuar zemrën duke gjetur qetësi në tokë të huaj - pa e humbur vetveten. Njeriu që ka gjetur atdheun autentik në shpirtin e vet. Dhe kjo është me të vërtetë diçka e re. Romani është shkruar realisht. Në mënyrë të veçantë, shkrimtari i jep detajet kaq hollësisht sa që lexuesi ndonjëherë ka ndjenjën se faktet do të përdoren si dëshmi në ndonjë proces gjyqësor në të ardhmen. Aftësia/mjeshhtëria e tregimtarit, megjithatë qëndron në faktin se, pavarësisht renditjes së shumë detajeve dhe në anën tjetër të një pritiqe të mundshme, proza nuk tingëllon aspak e lodhshme. Dhe sa më shumë që lexuesi i afrohet fundit të romanit, është më i lehtë dhe tërheqës bëhet nga faqja në faqe, kështu që pothuajse të vjen keq që gjendesh në përfundim të tregimit.

"Romani do të surprizojë shumë me thellësinë e tij, por për këtë thellësi duhet të rritesh"

PËRFUNDIMIT, APO PRITJES SË VAZHDMIMIT?

Romani është konceptuar kronologjikisht, që nga ardhja e të riut shqiptar në një mjedis të ri, në një vend gjuhën e të cilit nuk e njeh, zakonet e të cilit nuk i di, ligjet e të cilit jo gjithmonë janë të favorshme për punëtorët e huaj dhe në raste të ndryshme ka keqkuptime dhe konflikte midis njerëzve të kombësive të ndryshme, por edhe në nivel emigrantësh dhe vendasish. Karakteri kryesor i romanit, duke portretizuar historinë e tij në vetë të parë, në këtë luftë të mbijetesës totale është një ndryshim i rëndësishëm në krahasim me shumë të tjerë, të cilët e shohin integrimin e tyre në një mjedis të ri thjeshtë, duke refuzuar autenticitetin e tyre dhe pranimin e të resës, duke përdorur pa kritere morale privilegjet që ofron shoqëria e re. Pra, ata në fakt bëhen trupi i huaj i asaj shoqërie dhe kudo që munden - refuzojnë ose shmangin zakonet, detyrimet dhe ligjet, më saktë, edhe një shoqëri që ofron mikpritje, ata nuk e pranojnë në të vërtetë. Nga ana tjetër, personazhi kryesor, i ringjallur në personin autor i librit, është i kthyer dhe bashkangjitur vlerave themelore që sollin nga vendi i tij, duke e pasuruar kështu mjedisin e ri. Nëse ekziston lehtësi në leximin e këtij romani, atëherë ajo nuk

në mjedisin e ri. Momenti kur ai prek fundin e fundit. Por këtu, më në fund, del në pah ose kapitalizohet angazhimi ndaj virtyteve njerëzore, që personazhi kryesor ka përfaqësuar/kuruar gjithë jetën e tij, sepse familja e tij e re nuk është më vetëm, por e rrethuar nga miqtë e tij austriakë. Dhe kjo po e kthen sërish në jetë. Në të njëjtën kohë mbyllet unaza e integritimit. Njeriu, i cili është duke u përpjekur të jetë i sinqertë dhe i drejtë, i rrethuar nga të njëjtat njerëz si ai, pavarësisht kombësisë, tregohet si floriri dhe mbi të, diamanti. Që nga ai çast fillon rritja reale e familjes shqiptare në shoqërinë austriake. Besimi, miqësia, besnikëria, dashuria nuk kanë kufi. Dhe i ardhuri nuk është më i huaj. Është artisti ose siç e quajnë tashmë austriakët "Herr Künstler" mbasi, afirmimi i tij i mëtejshëm realizohet natyrisht, bazuar në aftësitë dhe talentet që disponon dhe i vë në shërbim në mjedisin e ri.

qëndron në komplotin intrigues të veprimt, por qëndron në të vërtetë. Dhe kjo e vërtetë është në shërbim ose, më mirë të thuhet, në mbrojtje të jetës. Le të marrim shembullin, ndoshta fragmentin më të ndjerë dhe më dramatik, në të cilin autori përshkruan humbjen e fëmijës së tij gjatë lindjes. Të përjetuarit e thellë, si dhe seria/vargu psikologjik i ndërthurur filigranisht, gjatë kësaj ngjarjeje mund të jetë pika më e ulët e ekzistencës së figurës kryesore

Në gjurmët e këtyre zhgëimeve është e mirë të shihet me kujdes titulli i këtij romani. Pavarësisht nga fjala "Udhëkryq", të sfaqet ideja si një pikëpamje gjeografike-pamje e udhëkryqeve të shqiptarëve nga të cilat vjen ose shkon secili prej nesh në drejtime të ndryshme. Por të ndalesh në kryqëzim/udhëkryq do të thotë të gjendesh në vendin e vendimit. Në ç'drejtim shkohet? Sepse hapi i parë vendos për

të tjerët. Kështu është edhe në shpirtin ose zemrën e njeriut. Udhëkryqi ndodh të të gjithë me. Ne të gjithë udhëtojmë deri në një pikë ku duhet të merret vendimi. Vendi fshin të drejtën/fatin fatal. Për shumë njerëz, fati është jeta, sepse në udhëkryq kryesor ata nuk morën vendimin e duhur. Ndërsa romani i Fate Velaj është një konfrontim me vendimin. Këtu më sfaqet intensivisht një pamje nga vendlidja ime, Podravina. Burrat e mençur, në dukje primitivë, që punonin në fushë, dinin të thoshin: "Nëse duhet, pëshytyje veten në fytyrë, por mbaje atë gjithnjë të pastër!" Evropa ka shumë të mësojë nga kombet e vegjël dhe anasjellas.

Romani "Udhëkryqi" i Fate Velaj do të surprizojë shumë me thellësinë e tij, por për këtë thellësi, duhet të rritesh/përgatitesh. Për fat të keq ka shumë që nuk janë në gjendje të marrin frymë në këto thellësi. Atyre iu takon sipërfaqja. Të tillë sot godsin me shklopinj nëpër shkurre të mëdha (vende dhe popujt më gjuhë të mëdha) se si të mund të nxirrin prej aty, lepurin e madh, por lepuri, nganjëherë, kërcën nga shkurrja e vogël dhe romani Kreuztanne i Fate Velaj është dëshmia më e mirë për këtë. Shkrimtari Fate Velaj me romanin e tij ndriçoi nderin e shqiptarëve dhe të Shqipërisë. Për të shprehur se do ta bëjë këtë edhe në të ardhmen. *Shkrimtar, Zagreb, 18 mars 2019.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

*Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 4,000,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë parapërkohshëm pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutjesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare" Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 15 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 653

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Allaj - Art Designer: Nevila Samarkhi
E shtunë 23 Mars 2019

KENGETARET

PERPLASJET



MBAROI 'LUFTA E FTOHTE'! ENCA DHE NOIZY RIKTHEHEN BASHKË?



Flor Mumajesi pas deklaratës së Sabri Fejzullahut për klikimet: Nuk t'i kam marrë ty paratë!

GRACIANO TAGANI

U largua nga "Klan": Shyqyr që ndodhi!



Balerini: Prapaskenat e programit të ri, VIP-at janë 100% realë. Asgjë nuk është ashtu siç duket



VOGËLUSHËT

e VIP-ave mbulohen nga luksi. Nga bebushi i Adelinës te vajza e Loredanës dhe Mozikut

Nga bebushi i Adelina Tahirit te vajza e Loredanës dhe Mozikut, veshjet më të shtrenjta për fëmijët

Vogëlushët e VIP-ave mbulohen nga luksi

Trendi që nga mosha 0, kush vishet me mijëra euro për një xhiro

Pamela Aliaj

Luksi në ditët e sotme është një element, i cili identifikon personazhet VIP të huaj dhe jo vetëm. Trendin e të veshurit me firmat më të shtrenjta e me modellet më të fundit mesa duket prindërit e rinj e kanë transmetuar edhe te fëmijët e tyre që në vegjëli. Kjo ka nisur që herët, por ka qenë element identifikues i familjeve mbretërore. Ndërkohë që luksi tani është element identifikues i VIP-ave në gjithë botën duke filluar që nga familja Kardashian, Beyonce e Jay-Z, këngëtar-

ja latine Cardi-B e sigurisht që një trend të tillë nuk kishin si mos ta ndiqnin edhe VIP-at tanë shqiptarë. Në një përmbledhje të shkurtër kemi sjellë një album me veshjet e foshnjave apo dhe vogëlushëve që s'kanë mbushur ende 1 apo 2 vjeç të mbuluar nga firmat më të fundit e veshjet më të shtrenjta. Nga mijëra euro për një kombinim për të dalë xhiro me mamin e babin, kush janë foshnjat që mbajnë në trup firmat më të shtrenjta të momentit.



Adelina Tahiri me djalin Jon Markov

Ajo është bërë nënë para disa muajsh. E Joni duket se do të rritet i veshur vetëm në rroba të firmave më të njohura. Kjo pasi këngëtarja Adelina Tahiri që në lindjen e tij u përkujdes që djali i saj edhe të flejë në rroba të shtrenjta. Ajo në një fotografi të publikuar në muajt e parë të vogëlushit tregon se Joni ka edhe shtratin dhe rrobat e gjumit të veshura me firmën e njohur 'Burberry'. Si dhe karroca e tij është e firmës së njohur Cybex, e që nga një kërkim në Internet, kushton 1800 euro, shtuar dhe çmimin i kolltukut të foshnjës 300 euro, plot 2100 euro gjithsej.

Nora Istrefi dhe Robert Berisha me vajzën Rene



Këpuçët dimërore që ajo ka veshur kur ka qenë shumë e vogël, të markës Timberland, kanë vlerën e 130 eurove, ndërsa pallto e Burberry arrin vlerën e 507 euro. Ndërkaq që fustani i saj i parë i veshur për Babyshower-in e saj ishte i firmës Christian Dior dhe kushtoi jo më pak se 890 euro.



Rene, vajza e vetme e këngëtarëve kosovarë Nora dhe Robert Berisha ka veshur që në moshë të vogël firmat më të njohura të kohës dhe të shtrenjta gjithashtu. Që pa mbushur një vjeç atë e shohim nëpër postime me veshje të ndryshme si: Burberry, Dior, Timberland, Addidas, Zara kids etj.






Lumi B dhe djali i tij, Blini:

Këngëtari i njohur Kosovar, Lumi B nuk heziton të paraqesë në Instagram veshjet e djalit të tij plot stil dhe shumë të shtrenjta. Blini vishet me Addidas, Zara kids, Timberland, Nike dhe ka raste edhe me veshjet të tjera si Givenchy e kemi parë të veshur vogëlushin. Ndërkaq në koleksionin e ri të Addidas by Kanye West, djali i reperit i kishte të tri llojet e atleteve të cilat kalonin çmimin e 400 euro secila. Ndërkohë që nuk mungojnë dhe modelet e fundit të Nike për fëmijë që të gjitha i gjen tek garderoba e Blinit, të cilat arrijnë vlerën e mbi 500 euro. Ndërsa në koleksionin e limituar të Givenchy për Nike arrin vlerën e 600 euro të veshura tek Blini. Ndërkohë që në sezonin që kaluam të dimrit, djali i reperit u vesh me firmën Timberland kids që kap vlerën e 600 euro.



Loredana dhe Mozzik me vajzën e tyre Hana

Mozzik dhe Loredana 4 muaj më parë u bënë për herë të parë prindër të një vajze të cilën e pagëzuan me emrin e veçantë Hana. Loredana dhe Mozzik e kanë shfaqur kujdesin ndaj vajzës dhe duket se nuk i mungon asgjë. Veshjet e saj firmato dhe plotë stil kanë tërhequr vëmendjen e të gjithëve. Së fundmi, Loredana ka publikuar disa foto ku tregon se i ka blerë dy dhurata të bijës. Në videot dhe fotot e postuara shihen një palë këpucë të vogla dhe një pallto, të dyja të markës luksoze Guçi. Në një kërkim në google rezultojnë se këpucët kanë kushtuar 150 euro, ndërsa palltoja rreth 877 euro, pra në total 1027 euro.



Jonida Maliqi dhe djali i saj, Dan

Këngëtarja e cila do të na përfaqësojë me këngën e saj "Ktheju Tokës" në Eurovision këtë vit njihet për veshjet e saj trendy dhe të shtrenjta. Por një stil të tillë ia ka transmetuar dhe djalit të saj, Dan. Që i vogël ai është parë me veshje të shtrenjta si: Hermes, Kenzo, Burberry, MCM, Addidas etj. Edhe pse këngëtarja është treguar shumë e rezervuar në ekspozimin e djalit të saj, njerëzit e afërt e kanë vënë re veshjet e tij të shtrenjta. Po të bëjmë një kontroll të vogël në internet vetëm një rrip i Hermes për fëmijë kushton 1000 euro. Ndërkaq Kenzo është firma e preferuar e Jonidës dhe jo vetëm e cila është më e lirë se Hermes ku varion në çmimet nga 50 paund deri në 200 paund. Çanta e MCM që ka Dani arrin vlerën e mbi 1000 euro ku paraqit shijen tipike të nënës së tij të veshurit trendy dhe konfort. Ndërkohë që atletet e Addidas nga Kenye Ëest arrijnë vlerën e 400 euro.



Pamela Aliaj

Largimi i tij nga "Klani" bëri shumë bujë në mediat rozë dhe arsyeja e këtij largimi ka bërë që të jetë në qendër të vëmendjes për disa javë. Por, shumë shpejt ish-balerini i trupës së Albi Nakos e gjeti veten në një projekt të ri krejt të tijin, që do e sjellë në ekranet shqiptare. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Graciano Tagani na rrëfen projektet e reja në "Dance with Graciano" si dhe prapaskenat dhe të pathënat e largimit të tij nga "Klani" për të nisur tashmë një aventurë të re të aprovuar më parë.

Tani do ta shihni jo vetëm si balerin, por edhe si moderator. "Gjithmonë kam dashur të bëj gjëra ndryshe dhe synimi im përveç baletit, ka qenë të drejtoja një 'reality', ose një program 'funny', ose të bëja një film. Duke qenë se me baletin kam arritur çdo gjë të mundshme për sa i përket Shqipërisë, ishte momenti të ndiqja synimet e tjera që kam", ka thënë ndër të tjera Graciano. Gjithashtu, ai ka rrëfyer edhe disa të pathëna lidhur me jetën e tij private dhe "kushtet" që ka vendosur për të dashurën e tij të ardhshme: "Jo balerinë", - thotë

Rrëfëhet balerini: Prapaskenat e programit të ri, VIP-at janë 100% realë

U largua nga "Klan", flet GRACIANO TAGANI: Shyqyr që ndodhi!

"Asgjë nuk është ashtu siç duket"

duke qeshur Graciano. Këto e të tjera në intervistën e mëposhtme.

Keni nisur projektin e ri "Dance with Graciano". Si erdhi ideja e këtij projekti?

Gjithmonë kam dashur të bëj gjëra ndryshe dhe synimi im përveç baletit ka qenë të drejtoja një 'reality', ose një program 'funny', ose të bëja një film. Duke qenë se me baletin kam arritur çdo gjë të mundshme për sa i përket Shqipërisë, ishte momenti të ndiqja synimet e tjera që kam.

Cili ka qenë personazhi më i vështirë që keni pasur për t'i mësuar të kërcejë gjatë eksperiencës tuaj si balerin?

Personazhe të vështira ka pasur plot, sepse profesioni ynë është shumë i vështirë dhe normal s'ka qenë e lehtë për ta. Nuk do të doja të përmendja emra, por zakonisht janë emrat të bërë emra nga hiçi.

Jeni një balerin që keni kohë në skenë, jeni afirmuar në shumë evente dhe emisione. Cila ju ka lënë më tepër mbresa?

Për mua ka qenë e para "Star Akademi", ku konkurroja dhe ishte sfida ime në adoleshencë dhe pa diskutim "Dancing with the Stars".

Tashmë keni zgjedhur të jeni pjesë e "Mos i fol shoferit". Si ndiheni në këtë projekt te ri nën rolin e moderatorit?

Ka qenë synimi im dhe jam shumë i lumtur që po bëj këtë gjë. Jam në fillimet e mija për sa i përket moderimit, por jam i sigurt që do t'ia dal.



A e keni parë veten të vijoni këtë rrugë si drejtues i një programi kërcimi?

Po, normal që po dhe shumë shpejt do mundohem të sjell në Shqipëri një projekt të tillë.

Pas largimit nga "Klan" keni pasur me siguri shumë kërkesa nga 'show' të ndryshëm. Pse zgjodhët pikërisht të bashkëpunoni me Rudina Dembacajn?

Sepse ishte ajo që doja dhe normale, ku ka më mirë





se të punosh me njerëz të aftë, të pastër dhe me shumë karakter si Rudina.

Cili është personazhi VIP që iu është dashur ta mësoni të kërcëjë, që ka aftësi më të mira kërcimi? Po ai/ajo më pak i/e aftë për kërcim?

Aftësi më të mira për kërcim ka Olta Boka, ndërsa më

pak Cekja. (qesh).

Keni thënë se jeni larguar nga "Klan" me një SMS. Nuk keni dashur të reagoni lidhur me një veprim të tillë të papritur?

Jo, unë reagoja dhe publikisht madje (qesh). Por nga një anë, shyqyr që ndodhi!

Ndërkohë, përveç projektit që keni të "Dance

with Graciano", me çfarë tjetër jeni duke u marrë?

Me menaxhimin e balerinëve që kam dhe projekte të ndryshme nëpër kompani të ndryshme.

Për çfarë bëhet fjalë më konkretisht në programin "Dance with Graciano"? Ç'të veçantë ka nga programet e tjera?

Ideja është që çdo VIP të mësojë të kërcëjë diçka të vogël dhe ndërkohë që bën këtë gjë, i bëhen pyetje të sikletshme, ku i humbet edhe përqendrimi për kërcimin (qesh). Është pa doreza si 'show'. Është një rubrikë ku nuk ka skenar siç jemi mësuar zakonisht dhe për këtë ju siguroj që VIP-at janë 100 për qind si në jetën e tyre reale.

Do të preferoni ta kishit partneren në fushën e baletit, apo nuk e keni kusht profesionin?

Jo, aspak s'do e doja balerinë (qesh). Le të jetë çfarë të dojë, mjafton të më dojë dhe ta dua.

Cili është kushti kryesor që nuk toleroni në një lidhje?

Nuk toleroj moskorrektësinë, neglizhencën dhe monotoninë.

Cila është shprehja që ju jep muzë në jetën tuaj?


Shprehja që më jep muzë është "Asgjë nuk është ashtu siç duket".






Mbaroi 'lufta e ftohtë'! Enca dhe Noizy rikthehen bashkë?

Që prej vitit 2017, Enca dhe Noizy i dhanë fund miqësisë së tyre dhe nuk folën më me njëri-tjetrin. Ky ishte një ndër sherrat që bëri shumë bujë në showbiz-in shqiptar. Për të treguar së miqësia e tyre është prishur, këngëtarja fshiu nga kanali i saj zyrtar në "Youtube" videoklipin e këngës "Bow down" që ishte hit. Por duket se gjërat kanë ndryshuar. Enca i ka habitur fansat së fundmi me postimet e saj në "Instastory". Ajo ka zbuluar se e ka rikthyer sërish në "Youtube" këngën që ka në bashkëpunim me reperin. "U rikthye në Youtube. E di që ju kishte munguar", shkruan Enca në postimin e saj të parë. Ndërkohë më pas, këngëtarja ka postuar një video ku shfaqet ajo duke kënduar këngën "Bow down". Por, a tregon kjo një afrim të mundshëm të Encës me Noizy-n? Çfarë po ndodh mes tyre? Gjithsesi veprimi i Encës në një farë forme tregon se ajo nuk i mban më mëri reperit dhe ky është një lajm i mirë për fansat e të dyve.



Nënë për herë të parë, Anjeza Shahini publikon fotot më të ëmbla me vogëlushen Viktoria

Vetëm para pak javësh Anjeza Shahini u bë nënë për herë të parë. Ajo e publikoi lajmin e bukur më datë 8 të këtij muaji duke treguar lumturinë që provoi duke festuar ditën e gruas, për herë të parë në statusin e një nëne. E vogla që erdhi në jetë u pagëzua me emrin Viktoria dhe po rritet e shëndetshme pranë nënës dhe babait të saj. Ndërsa së fundmi, Anjeza ka publikuar sërish disa foto të vajzës së saj, këtë herë paksa më të dukshme, megjithëse është kujdesur ta fshehtë imazhin e së voglës. Në njërin prej tyre e bija sapo është larë dhe këngëtarja ka zgjedhur ta ndajë me ndjekësit këtë moment, si një nga më të bukurit që ka shansin të provojë një nënë. Ndërsa foto tjetër është shkëputur nga një shëtitje e Viktorias me të ëmën. "Le t'i vëmë në lëvizje këto rrota", shkruan ajo në foton në fjalë duke ju referuar karrocës. Megjithëse nuk duket shumë mirë për shkak të veshjes, Anjeza i është rikthyer formave të periudhës para shtatzënisë dhe duket shumë mirë!



Reagon Flor Mumajesi pas deklaratës së Sabri Fejzullahut për klikimet: Nuk t'i kam marrë ty paratë!

Ka shkaktuar një debat të madh mes dy personazheve të njohur, deklarata e këngëtarit të suksesshëm Sabri Fejzullahut, në një program televiziv ku përmendi emrin e Flori Mumajesit teksa fliste për blerje klikimesh. Ndërkaq nuk e ka lënë me qaf Flori ku ka reaguar me një postim të tijin në 'Instagram'. Krahas videos së publikuar me fjalët e Fejzullahut, kantautori i njohur ka shkruar: "Pse kapeshe me mua axha Sabri? Edhe po t'i kem blerë nuk t'i kam marrë ty paratë. Pse mërzitesh kaq shumë? Aman mos më. Flori edhe kur të tjerët kanë ngrënë i ka lënë në punë të vetë se nuk kam qenë dhe nuk jam shembull për blerje klikimesh. Askujt nuk i ndërhyj në jetën e tij. Kur arrijnë vetë shumë klikime nuk dëgjohej, vetëm fërkojnë gjoksin sikur janë artistë të mëdhenj, ndërsa kur nuk i bëjnë vetë merrin me llafë". Megjithëse gjatë deklaratës, Sabri Fejzullahu ka kërkuar ndjesë që po përmend emra, ai nuk nguroi të flasë për fenomenin që është shumë i pranishëm në tregun shqiptar. Flori ka zgjedhur këtë mënyrë për të hedhur poshtë deklaratën e kolegut të tij, të paktën për veten e tij.



'Xing' me veshje! Rudina dhe Bieta veshin pizhame në studio dhe ja 'justifikimi' i tyre

Të guxuarit në modë me veshje nga më të ndryshmet tashmë nuk përbën më lajm ditët e sotme. Ndërkohë që të ardhurit me pizhama si moderatorja Bieta Sulo, e cila i veshi dy ditë më parë në studion e "Ftesë në 5" dha një efekt më se të kënaqshëm. Ndërsa një tjetër moderatorje zgjodhi të vijë në studio me trendin e momentit të pizhameve. Rudina Magjistari surprizoi jo pak, teksa bëri hyrjen në studion e "Rudina", e veshur me një kostum që ngjante si pizhame. Moderatorja rrëfeu në nisje të programit se këtë veshje e për hir të së vërtetës e kishte me pak merak, sepse i frikësohej reagimit të publikut që do të mendonte se ajo ka veshur pizhame, por duke qenë se ky është trendi i momentit, Magjistari e mori risikun. Ndërkohë që të dyja u justifikuan me faktin se është diçka e kohës që shumë prej të pranishmëve dhe audiencës mund ta keqkuptojë, por që nuk ndodhi aspak! Trendet e reja duket se po priten shumë mirë dhe nga publiku e asgjë nuk ka bën përshtypje si më parë.




Klaudia Pepa publikon videon në 'Instagram', Albi Nako jep reagimin e shumëpritur

Edhe pse divorci i tyre bëri bujë, marrëdhënia mes Albi Nakos e Klaudia Pepës vazhdon të tërheqë shumë vëmendje dhe është në qendër të mediave rozë. Klaudia ka arritur të krijojë tashmë një karrierë në Itali, dhe poston vazhdimisht pjesë nga aktiviteti i saj në rrjetet sociale. Por postimi i fundit ka tërhequr më shumë vëmendje, dhe kjo për shkak të reagimit të Albi Nakos në të. Balerina kishte hedhur videon e radhës ku shihej bashkë me grupin e saj duke kërcyer nëpër rrugë, dhe koreografi i ka dërguar asaj disa emoji duartrokitje, duke treguar kështu admirimin e tij! Një marrëdhënie për t'u marrë shembull e të dyve.




Si është të punosh me partnerin? Klea dhe Elgiti tregojnë prapaskenat e studios

Ata janë çifti më i ri i sapofejuar në median rozë. Janë pothuajse kudo bashkë dhe herë pas here na ndajnë momente të kaluara në rrjetet sociale. Së fundi Klea dhe Elgiti po punojnë për një projekt të ri dhe ka qenë Klea që ka ndarë me ne momente nga puna në studio. Elgiti si më profesionist në këtë fushë, po e "kritikon" Klean të zgjasë notat, por Klea shkrihet së qeshuri dhe nuk ndalon dot. Më pas Klea bëhet më serioze, por më kot, pasi kjo puna e zgjatjes së notave i shkakton të qeshura. Ndër komentet dashamirëse që çifti merr gjithmonë, veçon ai i moderatorit Turjan Hyska që shkruan "Bën kot si profesor, po të gjuan, e vdekme". Duhen momente të tilla në një marrëdhënie që ta bëjnë dhe më të veçantë apo jo?




Alketa Vejsiu bëhet nostalgjike: "Ua e pabesueshme, shikoni çfarë kam gjetur!"

Moderatorja e njohur Alketa Vejsiu së fundmi është bërë mjaft nostalgjike për kohët e fëmijërisë dhe ka publikuar vjershat e saj të krijuara në vitin 1996. Vejsiu ka shpërndarë me ndjekësit në 'Instagram' disa video, teksa bën publike përmbajtje nga gazeta e parë që ajo ka bërë në shkollë. Moderatorja e dashur për publikun, siç mund ta kuptoni nga videot e postuara është emocionuar tej mase dhe është shprehur në këtë mënyrë: "Ua e pabesueshme, shikoni çfarë kam gjetur. Maj, viti 1996, Vogëlushët. Kjo është gazeta e parë që kam bërë unë në shkollë. Ua e paparë, fantastike! Alketa Vejsiu bënte poezi. Ç'i kam këto poezi kështu që kam bërë. O Zot, e pabesueshme! Sa kujtim i bukur. Klasa e gjashtë. Kam qenë fiks sa është goca ime sot. Ky ka qenë botimi i parë." Ëhë, Alketa ka qenë fiks në klasë të gjashtë kur ka shkruar poezinë që sapo dëgjuat. E talentuar, apo jo?



Reperi i njohur i lidhur me motrën e Loredana Zefit? Ja çfarë e zbuloi lidhjen e tyre

Është përfolur prej kohësh që Gent Fatale, reperi i njohur se është në lidhje me një vajzë simpatike, e cila quhet Rozafa. Aludimet kanë vërshuar si pasojë e postimeve të publikuara, ku Genti dhe Rozafa shfaqen shumë pranë njëri-tjetrit. Por lidhja e tyre nuk është konfirmuar publikisht, ndërkohë reperi vijon që në daljet e tij publike ta quajë bukuroshen, vajzë halle. Së fundi, këngëitari ka qenë i ftuar në emisionin "Fun Day", prej ku me gjestet e tij, konfirmoi se është i lidhur me Rozafën. Moderatorja e emisionit në fjalë, Fatma Methasani gjatë intervistës, teksa shfaqej një foto e reperit me vajzën brune, i tha Gentit: "Këtë foton e keni yll, super çift jeni ë...!" Reagimi i reperit ishte epik. Nga njëra anë ai e ka mohuar të ketë lidhje me Rozafën duke thënë: "Si thua çift, si na nxjerr kështu çift? Çfarë është kjo?" Nga ana tjetër, ka filluar të qeshë, duke lënë të nënkuptohet që vërtetë është i lidhur me të.



Opinion *i* Ditës

"Qeverinë që duam apo nuk duam" e rrëzojnë vetëm...socialistët

Shkruar nga Xhevat Mustafa

(villon nga faqja 1)

... shikohet edhe në Paris, prej rreth 5 muajsh e sic ka ndodhur edhe në Romë, Athinë, tri qytete që njihen si kryeqytete të kulturës dhe demokracisë botërore, edhe në atë të 16 shkurtit, në Tiranë, kryeqytet i një vendi me "demokraci foshnjore", pati disa akte dhune e shkatërrimesh. Duke e vazhduar krahasimin me atë të 21 janarit 2011, organizuar nga PS dhe "udhëhequr personalisht me mençuri dhe largpamësi" nga vetë kryetari Edi Rama, protestat e opozitës mund të cilësohen edhe sfilata apo parada... mode të veshjeve, flokëve, grimit të fytyrave, bukurisë së femrave... Nejse, duhet t'i largohem kësaj hyrjeje, sepse ideja e këtij shkrimi të sotëm nuk është analiza e formës, karakterit, frytëve dhe dëmeve të protestave të opozitës... Personalisht, duke i njohur shumë mirë opozitën dhe pozitën, Edi Ramën dhe Lulëzim Bashën, mënyrat dhe format e tyre të reklamimit mediatic, të synimeve e të platformave të tyre të kundërvënies në parlament dhe jashtë tij, qysh më 6 tetor 2016, ose afro 9 muaj para gjasjeve zgjedhjeve të 25 qershorit 2017, në analizën me titull "Edi Ramën nuk ka kush ta rrëzojë", botuar në "Gazeta Shqiptare" dhe "Balkanweb", jam shprehur se Edi Ramën dhe qeverinë e tij mund ta rrëzojnë vetëm vetë PS-ja në tokë dhe Zoti në qiell... Ky konkluzion mbështetet edhe në faktin se me humbjen të zgjedhjet e 23 qershorit 2013, PD-ja, personalisht Sali Berisha, me apo pa dashje, ia lanë pushtetin në duar Edi Ramës me shokë e shoqe, shoqëruar edhe me disa "dhuurat" të tjera. Fjala ishte, së pari, për katandisjen e PD-së si në gjendje komë dhe, për më tepër të vendit pa opozitë të vërtetë, pa sindikata të fuqishme, të afta për përmbyesje qeverish e për rrotacion qeverisës, pa popull ose me popull të zhgënjyer nga të dy palët, që e besonte dhe e vazhdon ta besojë përallë propogandistike hedhur në treg "quditërisht" apo jo rastësisht pas 23 qershorit 2013 se "të dy palët janë njësoj"... Natyrisht, edhe më 6 tetor 2016, edhe sot, PS-ja, edhe pse e katandisur nga Edi Rama me shokë e shoqe si një magazinë votash dhe mitingashesh dhe si një nga pronat e shumta të kryetarit, vazhdon ta mbështesë mavisisht "qeverinë rilindase". Edhe më keq, edhe piramida e strukturave të PS-së janë formalizuar dhe pronësuar nga Edi Rama, duke e bërë demokracinë e brendshme "një përrallë nga e kaluara e largët". Kjo nënkupton se mund të llogaritet si i pamundur ndryshimi i lidership-

it partiak dhe qeverisës nga brenda. Megjithatë, ndryshimi që kanë sjellë koha, kriza, kolapsi shumëformësh e shumëgjyresh, korrupsioni i pafre i disa ministrave dhe ministrave, koncesionet e dhuruara ose oligarkëve ortakë ose askushëve 26-27 vjeçarë dhe receptionistë, është se, sidomos në dy vitet e mandatit të dytë, një masë e socialistëve me teserë, me zemër dhe bindje, nuk mundën t'i përmbajnin të fshehin më pakënaqësitë, zhgënjimet, kritikën, ankesat... ndaj saj, domethënë ndaj "qeverisë që duam". Apo se kanë 74 vjet që janë vetësakrifikuar për gjasmë të majtë, pa ju kthyer prej saj as çereku i sakrificave të tyre. Mes socialistëve nuk janë të paktë ata që kanë sy, mendje, pjekuri kurajë të bëjnë një analizë të thellë e të sinqertë, afërsisht sipas kësaj logjike dhe forme. Koha ka 74 vjet që rrjedh e ne, që jemi peng apo robër të se majtës, jemi rrotulluar si kuajt në lëmë, pa dalë në breg apo pa u ngjitur në majë. Të fundit në Evropë ishim më 29 nëntor 1944 dhe të fundit jemi edhe sot në mars 2019. Atëherë rritim në radhët për bukë, qumësht, mish, vezë..., sot fëmijët dhe nipërit tanë, me gra e fëmijë, në dyert e ambasadave të SHBA-së, Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Kanadasë... për të ikur për në vende të kapitalizmit, ku përgjithësisht qeveris e djathta dhe jo drejtë Rusisë, Kinës, Kubës, Koresë së Veriut, Venezuelës, Serbisë... ku kanë mbetur akoma në qeverisje "të majtë" komunisto-socialiste...

Kjo dukuri reflektimi dhe zhgënjimi që po masivizohet në gjirin e vetë të të majtëve jep arsye dhe shkas të shprehoshet se më në fund, pas 74 vjetëve, edhe qytetarë të majtë, po fillojnë të ndjehen, mendojnë dhe reagojnë jo padiskueshmërisht si partiakë, militantë, fanatikë, votues, si tifozë të çmendur të kryetarit, por më së pari si qytetarë, si kryefamiljarë, si prindër, gjyshër, si konsumatorë... Nënkuptueshëm, edhe si viktimë mashtrimesh dhe të plot të këqiave të përbashkëta, të hapura e të mbuluara me ndërime etiketash dhe të datave të prodhimit dhe të skandencës, me bojëra fasadash, flamurësh, leckash e lulkash në bulevardet e festa, që nuk mund ta mbulojnë lakuriqësinë e krizës, dëshitimit, varfërisë, korrupsionit... Dihet se edhe shumica e socialistëve po ndëshkohen njësoj nga keqqeverisja e "rilindjes", sepse marrin të njëjtat paga e pensione të ulta, paguajnë me të njëjtat çmime dhe me tendencë rritjeje dritat, ujin,




internetin, paketat e programeve televizive, biletat në aeroportin e Rinanit, arkivolin dhe atë copë tokë apo gropë në varreza... Blejnë me të njëjtat çmime në të njëjtat dyqane e supermarkete bukën, mishin dhe sallamet, bulmetrat, peshkun, ilaçet në të njëjtat farmaci. Po kështu, lindin fëmijë, mjekohen ose... vdesin në

të njëjtët spitale, sorollaten me muaj e vite njësoj në të njëjtat zyra të "qeverisë dhe të shtetit që duam". Kudo, njësoj, të djathtë e të majtë, janë viktimë dhe të njëjtëve politikane dhe qeveritarë të paafët, të papërgjegjshëm e të korruptuar, që shekizohen me miliona dhe miliardat nga djersja, gjaku dhe taksat e tyre, nëpërmjet ten-

derëve dhe koncesioneve, ndërkohë që ata si qytetarë varfërohen, sëmuren, rrënohen financiarisht dhe vdesin më shpejt e më me vuajtje nga ushqimet, biskotat, çokolatat, ëmbëlsirat, barnat, ajri, uji, bulmetrat, zarzavatet, frutat me nivele të larta hormonelesh, helmesh, ndotjeje, efektesh anësore, rreziqesh... Duke i një-

hur mirë të afërmit e mi familjarë, shokët, miqtë me bindje dhe votë të majtë, duke u qarë shpesh së bashku me ata për të njëjtat probleme, halle apo vuajtje, e marr me mend se nuk e kanë të lehtë ta braktisin, "divorcojnë" partinë, qeverinë dhe krahum e tyre të zemrës, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër, deri sa ato të reflektojnë dhe të korrigjohen sinqerisht thellë dhe gjerë, në pozitë apo opozitë e të meritojnë rikthimin në pushtet, pas një rilindjeje të vërtetë. Për të bërë këtë i tremb apo pengon edhe bindja apo alibia e investuar nga propaganda partiake dhe mediatike se "të dy palët janë njësoj" duke "harruar" qoftë edhe vetëm një fakt, se çmimet e shumicës së artikujve të ushqimit të përditshëm në mars 2013, niveli i faturave të korrupsionit nëpër zyrtarë e ministrave dhe drejtorive të përgjithshme, të një kilometri autostradë në terren fushor, nuk ishin kaq të larta se sa tani, në mars 2019. Shumë prej socialistëve të thjeshtë nuk e duan më Edi Ramën, sepse janë bindur cili është, cakt ka si idhuj, si shembuj apo modele, kujt i ka shërbyer dhe cilët po privilegjon dhe miliardizon, se ka afro 6 vjet që i mashtron me premtime, që "i harron" apo hedh në koshin e plehrave të nesërmen... Nuk "i ngrohet" apo ua shton shpresat si njeri dhe si lider as Lulëzim Basha me ekipin e tij, mbushur i njëloj si ekipi Rama, edhe me çuna e goca, pa CV të pasura, pa përvojë dhe besueshmëri të lartë... Basha i "lemëris" edhe nga fakti se duket dhe vepron si "nuse me shumë vjehrra" dhe jo si vetvetja. Mund të mendohet se ai e ka të vështirë të fitojë zemrat e shumë më tepër demokratëve dhe socialistëve dhe të shprehë më shumë besueshmëri për vizionin dhe aftësitë, duke qenë i rrethuar në Tiranë nga Xhaferri, Saliu, Edi, ambasadorët e SHBA-së, BE-së, OSBE-së... dhe në Bruksel nga Mogherini, Fleckensteini, Hahni...

Dashur pa dashur, emri, figura, prania, imazhi dhe "trashëgimia" e tij janë alibi apo "gogol" të sajuar dhe investuar nga e majta, që më shumë i dëmtojnë se sa u bëjnë mirë PD-së dhe opozitës. Realisht, këto janë arsye të forta për të nguruar ata socialistë idealistë dhe kontrribues të hershëm për PS-në, që nuk e duan më si në fillim Edi Ramën, shtetin dhe qeverisjen e tij. E keqja e tyre dhe e jona si shumicë e qytetarëve është mentaliteti i trashëguar nga Enveri, se të dalësh sot kundër qeverisjes së majtë, kundër "rilindjes", kundër Edi Ramës dhe ministrave dhe ministere- ➔



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 27 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 27.03.2019 (përfshirë TVSh-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOUNGE (6MG) 100 DSP 20 SSL	200 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhezimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhezimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk
 Rr. Murat Toptani, Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
 1000 Tirana, Albania
 Tel: +355 42 276 670


TIFOZËT MERITOJNË NOTËN 10



TKZ është spektakolare, koreografi dhe mbështetje deri në fund

Tifozeria e organizuar e Kombëtares, "Tifoza Kuq e Zi", ka shpalosur një koreografi speciale për ndeshjen kundër Turqisë. Në çastin kur po ekzekutoheshin dy himnet kombëtare, TKZ ka shpalosur një koreografi gjigante të kalasë së Krujës, simbol i rezistencës historike të shqiptarëve nën drejtimin e Skënderbeut, kundrejt pushtimit otoman. Kalaja shoqërohej nga një mesazh i qartë: këtu fitojmë ne! Gjatë gjithë ndeshjes, TKZ ka qenë e zjarrtë në tribuna, duke mbështetur ekipin Kombëtar pavarësisht humbjes.

PANUÇI E LA JASHTË



Açerbi: Strakoshës i besoj si vëllait tim

Tommaso Strakosha u la jashtë ekipit Kombëtar për shkak të keqe disiplinore, me trajnerin Kristian Panuçi, që nuk toleroi vonesën e tij, duke i bërë një dhuratë të hidhur për 24-vjetorin e tij. Por ditën e sotme ka ardhur një deklaratë nga ana e mbrojtësit të Lacios, Açerbit, që vlerëson në maksimum gardianin shqiptar: "Strakosha? Ai është i ri, i besueshëm, i aftë. Unë kam besim te ai, nuk kam pse të shqetësohem për shokët e mi të skuadrës, i besoj atij si ta kisha vëllain", ishin fjalët e Açerbit që nuk kanë nevojë për shumë interpretim pasi tregojnë qartësisht besimin që ka futbollisti te portieri i Kombëtares shqiptare.

Dy gola, një për çdo pjesë loje, thyejnë Shqipërinë, e cila praktikisht iu dorëzua kundërshtarit

MESFUSHORI MEMUSHAJ

Ledian Memushaj është i sinqertë pas ndeshjes. Në komentin që dha për RTSH, mesfushori i Kombëtares deklaroi se dje asgjë nuk funksionoi. "Asgjë nuk shkoi, atë gol në fillim ia falëm. Pas golit nuk luajtëm keq, por i dyti na preu këmbët. Goli i dytë mbylli ndeshjen, më pas nuk patëm forca për të reaguuar. Në Andorrë një ndeshje ndryshe, duhet të reagojmë menjëherë", u shpreh Memushaj.

Kalaja kuqezi bie nga dy goditje të vetme

Turqia fiton me lehtësi në "Loro Boriçi"

Jeton Selimi

Shqipëria ka dështuar ndaj Turqisë. Skuadra kuqezi është thyer 2-0 nga ekipi i Senol Gunesh, që ka triumfuar në "Loro Boriçi" në ndeshjen e tij të parë si trajner i përfaqësueses turke. Ka qenë një lojë racionale ajo e miqve, që kanë shënuar dy gola me vetëm dy gjuajtje në portë, ndërsa Shqipëria, ndonëse është përpjekur shumë, sidomos në pjesën e parë, nuk ka arritur të shkaktojë dëme në prapavijën turke.

Pas dy momenteve mjaft të mira të kuqezinjve me Bekim Balën në minutën e 14-të dhe me Balliun në të 20-ën, Turqia kaloi në avantazh me anë të Burak Jillmaz. Në minutën e 21-të, sulmuesi turk përfiton nga një rreshtim i keq në zonë e lojtarëve kuqezi dhe kalon skuadrën mike në avantazh. Turqia shënon në momentin e saj të parë të rrezikshëm në kuadratin e Berishës. Pjesa e parë do të dhurojë një tjetër mundësi për kuqezinjët të shpërdoruar nga Uzuni, ndërsa ekipet do të shkojnë në dhomat e zhveshjes me rezultatit 0-1.

Pjesa e dytë nis si e para për Shqipërinë, që këmbëngul për të gjetur barazimin, por golin do ta shënojnë turqit, kësaj radhe me anë të Hakan Calhanoglu, i cili ka realizuar një gol shumë të bukur me të djathtën nga distanca, që e ka bërë të kotë hedhjen e Berishës.

Goli i dytë trondit Shqipërinë, e cila nuk reagon më në fushë, ndërsa Panuçi nuk arrin të bëjë asgjë për të ndryshuar lojën e Kombëtares dhe bëhet trajneri i parë kuqezi që e nis me humbje fushatën eliminatore që pas vitit 2000.

TIFOZËT SHAJNË NË KOR PANUÇIN

Minuta e 60-të e ndeshjes, pak pas golit të dytë të Turqisë, tifozët shqiptarë kanë nisur korët ofenduese në drejtim të trajnerit Panuçi. "Panuçi, Panuçi vafanculo" dëgjohej nga tribunat e "Loro Boriçit". Fakti që Turqia kryeson 2-0 ka mërzhitur pa masë tifozët, ndonëse duhet pranuar se loja e kuqezinjve ka qenë e mirë.



Trajneri i Shqipërisë

Panuçi justifikohet: Këta lojtarë kam

Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, italiani Kristian Panuçi, është shprehur pas ndeshjes se ekipi luajti me dy fytyra në pjesën e parë dhe të dytën, ndërsa sipas tij diferencën e bëri forma fizike. Sa i takon faktit që ekipi nuk shënon gola, Panuçi thotë se këta lojtarë ka në dispozicion

Sa e vështirë ishte të pranoje këtë rezultat?

Pjesën e parë, luajtëm mirë, krijuam, por rezultati tregon se ata shënuan, dhe ne jo. Në pjesën e dytë, treguam shumë pak, forma fizike ishte shumë e dobët, në krahasim me ta, dhe bëmë vetëm një gjuajtje në portë. Ishte një diferencë fizike.

Sa na dënoi goli i parë aksidental?

Në pjesën e parë patëm mundësi, por nuk shënuam. Gjithsesi, duhet ta shohim atë rast më mirë.

0 gola të shënuar, 10 të pësuar. Nuk bëhet fjalë vetëm për fat. Kjo është një seri ndeshjes. Si dalim nga kjo situatë?

Është e vështirë, sot (dje) futi 2 sulmues në lojë, por nëse nuk shënojnë, këta janë lojtarët, kjo është skuadra.

Pse është e vështirë të dalë topi nga mbrojtja? I vetmi që mund ta bëjë këtë është Memushaj, pse e luani në të majtë të mesfushës?

Kemi gjuajtur 11 goditje, dhe 3 në portë. Memushaj ka qenë më të majtë, por është dashur të dalë edhe përpara.

TRAJNERI I TURQISË



Gunesh: E kërkuam më shumë fitoren, Shqipëria e fortë

Trajneri i Turqisë, Senol Gunesh, është i kënaqur me fitoren e arritur nga ekipi i tij në "Loro Boriçi". Ai theksoi se goli i shënuar u lejoi të kontrollonin lojën dhe vlerësoi ekipin Kombëtar të Shqipërisë. "Ekipi që e kërkoj më shumë fitoren ishim ne. Ishte një ndeshje e egër. Edhe Shqipëria kërkoj fitoren, por pasi shënuam golin, e morëm në kontroll lojën. Shqipëria ka lojtarë të mirë, dhe do jetë një kundërshtar i fortë. Ne e kontrolluam lojën, dhe morëm rezultatit pozitiv".

U mbyllën takimet e mbrëmjes së djeshme, në kuadër të eliminatoreve të Europeanit 2020. Franca fitoi pastër me shifrat 1-4, në transfertën e Moldavisë, duke marrë 3 pikët e para në grup. Golat u shënuan nga yjet e kampionëve të botës në fuqi, Grizman, Varan dhe Zhiru në pjesën e parë, dhe Kilië Mbape në të dytën. Rivalja tjetër e Sh-



Anglia shkatërron Çekinë

Grupi H, fitojnë Franca edhe Islanda

qipërisë në grupin H, Islanda, fitoi në po në transfertë, me shifrat 0-2 ndaj Andorës. Bjarnason dhe Kjartanson shënuan nga një gol për secilin pjesë. Në takimet e tjera, Anglia

fitoi pastër 5-0 ndaj Republikës Çeke në "Uembli", ku ra në sy një tripletë e Rahim Sterling. Ndërkohë, Portugalia dhe Ukraina u ndanë një barazim pa gola.

